USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Проект за е-пристапно образование

Отворете ги прозорците

DORACAK PËR ARSIMTARË PËR PRAKTIKA INKLUZIVE KOMPJUTERIKE

ME APLIKIM TË TEKNOLOGJISË NDIHMËSE

DORACAK PËR ARSIMTARË PËR PRAKTIKA INKLUZIVE KOMPJUTERIKE

ME APLIKIM TË TEKNOLOGJISË NDIHMËSE

Shkup, shtator 2013

Botues: „Hapni dritaret“
Autorë: Magdalena Dimkova - Velevska
Përkthyes: Rexhep Alili
Fotografitë: nga arkivi i „Hapni dritaret “
Pamja grafike: Koma
Shtyp: Boro Grafika

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

376-056.26/.3:004(035)

DIMKOVA-Velevska, Magdalena

Doracak për arsimtarë për praktika (inkluzive) gjithëpërfshirëse kompjuterike me aplikim të teknologjisë ndihmëse / [autore Magdalena Dimkova-Velevska ; përkthyes Rexhep Alili]. - Shkup : Hapni dritaret, 2014. - 96 стр. : илустр. ; 23 см

ISBN 978-608-4602-08-8

I. Velevska, Magdalena Dimkova- види Dimkova-Velevska, Magdalena

a) Специјално образование - Лица со посебни потреби - Настава со компјутери - Прирачници

COBISS.MK-ID 95367434

PËRMBAJTJA

1. Përdorimi i kompjuterit në mësim me nxënës me nevoja të veçanta arsimore 7

1.1. Planifikim dhe zbatim i punës në kompjuter 9

Pse do ta përfshini kompjuterin në mësim? 10

Kompjuteri, si do ta lehtësojë monitorimin e mësimit për nxënësin? .. 11

Si do të kontribuojë kompjuteri në arritjen e qëllimeve prej planit ndividual arsimor? 12

1.2. Teknologjia ndihëse (hardueri dhe softueri) 15

Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në mësim 18

1.3. Përcjellja e përfitimeve nga përdorimi i kompjuterit dhe i teknologjisë ndihmëse 21

2. Përshtatja e materijaleve që përdoren në mësim 25

2.1. Rekomandime për përshtatjen e materijaleve mësimore 27

3. Shembuj të praktikave gjithëpërfshirëse kompjuterike 33

3.1. Shembuj praktik i përdorimit të kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse me përdorues në Qendrën për teknologji ndihmëse pranë „Hapni dritaret“ 36

3.2. Shembuj praktik i përdorimit të kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse prej arsimtarëve dhe përfaqësuesve të shërbimeve profesionale 48

4. Resurset 95

TË NDERUAR ARSIMTARË DHE BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL

Para jush gjendet doracaku për arsimtarë për praktika kompjuterike gjithëpërfshirëse me aplikim të teknologjisë ndihmëse, që ka për qëllim tu ofrojë informata praktike dhe rekomandime për përdorimin e kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse në mësim me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Bota moderne, e cila gjithnjë e më shumë po bëhet dixhitale, nuk duhet të paraqes vështërisi shtesë për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Shoqëria bashkëkohore ofron kushte të barabarta për arsim, punësim dhe në përgjithësi për jetë të të gjithë qytetarëve pa ndonjë kufizim në aspektin e aktiviteteve të përditshme. Teknologjia informatike sot, ofron burim të pashtershëm iformacionesh, arsim, punë, argëtim, komunikim dhe më e rëndësishme prej të gjithave, mundësi për të gjithë. Teknologjia ndihmëse, mundëson tejkalimin e vështirësive dhe qasje më të lehtë deri te qëllimi i dëshiruar. Pajisjet ndihmëse kompjuterike dhe softueri, kontribuojnë për pjesëmarrje efektive t të gjithë personave në çdo aspekt të jetës shoqërore, a me këtë edhe për për plotësimin e nevojave të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Arsimi si segment i rëndësishëm i zhvillimit njerëzor, sot gjithnjë e më shumë e përfshin edhe punën me kompjuter, përvetësim dhe përdorim të shkathtësive dixhitale dhe mundësi të qasjes në informata të ndryshme. Nevoja për arritje dhe zhvillim, gjithashtu

është më se e nevojshme dhe e rëndësishme edhe për persona me aftësi të kufizuara, me qëllim ato të marin pjesë aktive në jetën shoqërore. Kompjuteri dhe teknologjia ndihmëse mund të jenë vegla të rëndësishme, kurse diku vegël e domosdoshme në mundësimin e procesit mësimor për nxënësit me nevoja të veçanta dhe për ata me aftësi të kufizuara. Ata mund të ndikojë në masë të madhe në rritjen e arsimimit për nxënësit me nevoja të veçanta.

Doracaku, do t`ju ofrojë informata dhe shembuj nga përdorimi praktik i kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse gjatë punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Me qëllim që bashkëpunimi ynë të vazhdojë edhe më tutje, në Ueb-faqen e "Hapni dritaret" do të sigurohet hapësirë ku në mënyrë të vazhdueshme do të mund ti shkëmbeni përvojat tuaja nga praktika (inkluzive) gjithëpërfshirëse kompjuterike.

Falënderim i sinqertë ndaj arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, të cilët, pa kurrfarë hezitimi i shkëmbyen shembujt nga puna e tyre.

Shpresoj që ky doracak do gjejë aplikim në punën tuaj të përditshme..

Me respekt,
Magdalena Dimkova-Velevska

1 PËRDORIMI I KOMPJUTERIT NË MËSIM ME NXËNËS ME NEVOJA TË VEËANTA ARSIMORE

Përdorimi i kompjuterit në mësim me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, në masë të madhe mund ta lehtësojë mënyrën e prezentimit të njësisë mësimore, përcjelljen e mësimit nga ana e nxënësit si dhe vlerësimin e njohurive të nxënësit.

Deri para disa vitesh aspak nuk është paramenduar se personat me aftësi të kufizuara do të mund të përdorin kompjuterin, ose edhe nëse do e përdornin, do të ishte vetëm në aspektin argëtues. Përdorimi gjithnjë e më i madh i kompjuterit dhe dixhitalizimi në të gjitha sferat e jetës, e imponon nevojën e përdorimit të shkathtësive dixhitale te të gjithë. Shembujt pozitivë për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga njerëz të njohur me aftësi të kufizuara me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetës dhe afirmimit të të aftësive dhe mundësive që i ofron teknologjia informatike, në masë të madhe kontribuojnë në kapërcimin e paragjykimeve në lidhje me përdorimin e teknologjisë informatike dhe përfitimeve që i ofron për personat me aftësi të kufizuara.

Stiven Hoking (Stephen Hawking) është fizicient i njohur anglez, autor dhe profesor. Ai ka sëmundje neuromotorike progresive që e kufizon lëvizjen dhe të folurit. Me mbështetjen e teknologjisë Stiven Hoking, gjithnjë është aktiv në jetën e tij profesionale dhe atë private.[1]

Karli Fleishman (Carly Fleichmann) është vajzë e re me autizëm pa të folur verbal, e cila me ndihmën e kompjuterit komunikon me të tjerët, përgadit detyra shkollore dhe publikisht i promovon aftësitë e personave me autizëm.[2]

1 Më shumë informata mund të gjeni në http://www.hawking.org.uk/
2 Më shumë informata mund të gjeni në http://carlysvoice.com/

Aplikimi i kompjuterit në mësim mund të ketë rëndësi të madhe për nxënësit me lloje të ndryshme të nevojave të veçanta arsimore. Përdorimi i kompjuterit mund të gjejë aplikim prej drejtimit më të thjehtë të vëmendjes deri te domosdoshmëria për realizimin dhe ndjekjen e mësimit. Kompjuteri, përmes mundësive të ndryshme që i ofron, por i mbështetur edhe nga teknologjia ndihmëse, për disa nxënës mund të jetë mënyrë e vetme për ndjekje të pavarur të mësimit, si dhe aktivitet më të madh brenda orës së mësimit.

Përdorimi i suksesshëm i kompjuterit dhe i teknologjisë ndihmëse në arsim të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, varet prej nxënësit, prej arsimtarit, prej shokëve të klasës, mjedisi shkollor dhe prej prindërve.

Nxënës me nevoja të veçanta arsimore është ai i cili do t`ju drejtojë dhe do tu jep informata të mjaftueshme për planifikim dhe përfshirje të kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse në mësim, por do tu jep motiv plotësues për punën e mëtutjeshme.

Arsimtari, gjithnjë duhet ti merr parasysh: mënyrën e planifikimit të punës, përfshirjen e kompjuterit dhe të teknologjië ndihmëse dhe monitorimin e të arriturave të nxënësit me qëllim të arritjes së suksesit dhe qëllimeve më të larta arsimore të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Bashkënxënësit luajnë rol të madh në mbështetjen e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në nxitjen e aktivitetit të tij si dhe të socijalizimit në përgjithësi. Pranimi i mënyrës më të ndryshme të punës të bashkënxënësit të tij në jetën e përdtshme, për fëmijën me nevoja të veçanta arsimore ka domethënie të madhe, posaçërisht në pjesën që ka të bëjë me rritjen e vetbesimit, e ndjenjës së përkatësisë si pjesë e grupit, si dhe dëshira për pavarësim më të madh në kryerjen e detyrave shkollore dhe aktivitet më të madh gjatë orës së mësimit.

Prindët/kujdestarët, si partnerë në procesin e mësimit, gjithnjë duhet të jenë të njoftuar me mënyrën e punës dhe të arriturave të qëllimeve arsimore. Ata duhet të jenë mbështetje e arsimtarit dhe të fëmijës së tyre, t`u mundësojnë komunikim, bashkëpunim dhe informim të ndërsjellë për çdo ndryshim.

1.1 PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I PUNËS NË KOMPJUTER

Fotografia 1. Përdorim i tastierës me taste të mëdha

Planifikimi dhe zbatimi i punës në kompjuter me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore mund të konsiderohet si vegël shtesë gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore dhe vlerësimi i njohurive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Kompjuteri gjithnjë e tërheq vëmendjen e nxënësit pa marrë parasysh a bëhet fjalë për nxënës pa ose me nevoja të veçanta arsimore. Përdorimi i komjuterit mund të paraqesë pjesë të pazëvendësueshme për realizimin e mësimit, veçanërisht nëse ofron mbështetje, autonomi, nxitje dhe promovim të shkathtësive të nxënësit.

Me digjitalizimin e sistemit arsimor ne Maqedoni, përdorimi i kompjuterit gjatë punës me nxënës me Nevoja të veçanta arsimore nuk duhet të paraqesë vështirësi për arsimtarin gjatë planifikimit të mësimit.

Para se ta përfshini kompjuterin në mësim me nxënësin tuaj me nevoja të veçanta arsimore gjithnjë keni parasysh disa pyetje që do t`ju drejtojnë dhe do t`u ndihmojnë ta planifikoni punën me kompjuter:

- Pse do ta përfshini kompjuterin në mësim?
- Kompjuteri si do ta lehtësojë përcjelljen e mësimit për nxënësin?
- Si do të kontribuojë kompjuteri në arritjen e qëllimeve prej planit individual arsimor?

Pse do ta përfshini kmpjuterin në mësim?

Para se ta planifikoni punën në kompjuter, duhet të mendoni se në ç`mënyrë dhe si do t`u bëhet kompjuteri mbështetës në procesin e realizimit të përmbajtjeve mësimore dhe si do ti ndihmojë nxënësit në arritjen e qëllimeve mësimore.

Gjithnjë filloni me aftësitë që i kanë nxënësit. Monitorimi juaj i përditshëm i nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ju ofron informata për aktivitete të cilat nxënësi mund ti kryejë në mënyrë të pavarur, aktivitete për të cilat ka nevojë për ndihmë nga arsimtari ose bashkënxënësi i tij, ku has në vështirësi më të vogla ose më të mëdha gjatë përcjelljes së mësimit etj. Nga ana tjetër, merrni informata edhe prej prindërve ose prej personave tjerë profesional, që janë të njohur dhe punojnë me nxënësin për përdorimin e kompjuterit në shtëpi, çfarë shkathtësish kompjuterike posedon, në cilin nivel e përdor kompjuterin në shtëpi etj.

Këto informata do t'u ndihmojnë në përshirjen e planifikimit të përdorimit të kompjuterit në mësim, përkatësisht do t'u japin udhëzime në ç'mënyrë do ta përfshini kompjuterin, në cilat aktivitete dhe në cilën periudhë të orës mësimore.

Shembull 1: Në klasë keni nxënës i cili has në vështirësi në përqëndrimin e vëmendjes gjatë orës së mësimit dhe të komunikimit, gjithnjë ka nevojë ti ndërrohet aktiviteti, nga ana tjetër, ngrihet prej karriges, shëtitë nëpër klasë. Prej prindërve keni informata se, në shtëpi derisa është në kompjuter mund të udhëzohet dhe ta përqëndrojë vëmendjen gjer në gjysmë ore në një aktivitet. Me këtë nxënës mund të përfshini lojëra edukative që janë në lidhëshmëri me përmbajtjen mësimore që e realizoni, si p.sh. aktivitete me softuerët edukativ TooLKID dhe Gcompris. Gjithnjë informoni

bashkënxënësit për aktivitetet që i realizoni me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore dhe në fund të orës i jepni mundësi nxënësit që shkurtimisht të tregojë dhe demonstrojë se çka ka punuar.

Shembull 2: Në klasë keni nxënës me vështirësi të lehtë intelektuale dhe me vështirësi gjatë lëvizjes së lapsit në dorë. Duke e monitoruar nxënësin, keni vërejtur se më lehtë gjindet në kompjuter duke përdorur teknologjinë ndihmëse (tastierën me taste të mëdha) dhe në këtë mënyrë ka më shumë vetbesim gjatë mësimit në klasë. Me këtë nxënës mund të përdorni fletëzat mësimore në formë elektronike, të cilat do të përmbajnë ilustrime dhe kërkesa të rëndomta dhe konkrete.

Gjithnjë keni parasysh se përdorimi i kompjuterit në drejtim të arritjes dhe realizimit të përmbajtjeve mësimore, varet prej aftësive individuale të nxënësit. Pë këtë arsyse, shembujt e suksesshëm praktik prej kolegëve tjerë le t'u shërbejnë si propozim dhe ide për planifikimin e punës tuaj.

Kompjuteri si do ta lehtësojë përcjelljen e mësimit për nxënësin?

Kompjuteri si vegël e cila mund ta përmbajë (inkluzionin) gjithëpërfshirjen, ju ofron mundësi të pakufishme nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, në masë të madhe i zvoglon vështirësitë me të cilat ballafaqohet nxënësi me nevoja të veçanta arsimore.

Sipas S. T. Haselbring (S. T. Hasselbring) dhe H. V. K. Glaser (H. W. C. Glaser), përdorimi i teknologjisë kompjuterike në aktivitetet për shkrim-lexim, komunikim, hulumtim etj., mund t'u ndihmojë nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të ndjehen të barabartë me nxënësit të cilët nuk kanë nevojë të veçantë arsimore. Zhvillimi i pajisjeve më të sofistikuara që mund ta mbështesin arsimimin e nxënësve në formë më të rëndë me nevoja të veçanta arsimore, në masë më të madhe mund ti tejkalojnë kufizimet me të cilat ballafaqohen nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasë dhe të përcjelljes së mësimit.

Përcjellja e mësimit, përmbushja e kërkesave të dhëna prej arsimtarit, pjesëmarrja në orë dhe pjesëmarrja në aktivitete grupore për disa nxënës mund të paraqet vështirësi. Vështirësitë e këtilla, nëse nuk merren parasysh me kohë dhe nëse nuk gjendet mënyrë si të tejkalohen, mund të sjellin deri te pasiviteti dhe demotivim te nxënësi, por gjithashtu edhe te arsimtari.

Përcilleni nxënësin, regjistroni aftësitë e tij dhe përfshijeni kompjuterin që të arrini qëllime të caktuara, ta rrisni pjesëmarrjen e tij gjatë orës së mësimit si dhe të ndikoni mbi autoniminë e tij, motivim dhe pavarësi.

Kompjuteri mund të gjejë aplikim dhe ta lehtësojë mësimin, në situata kur nxënësi:

- Ka vështërisi kur shkruan me laps por, më lehtë mund ta përdorë tastierën (standarde, me taste të mëdha ose me tastierë virtuale);
- Ka vështirësi gjatë përcjelljes dhe leximit të tekstit në libër ose në materijaë të shtypur për arsye të madhësisë së shkronjave, kontrastit, mënyrës së prezentimit të përmbajtjes;
- Ka vështirësi në komunikim ose ka të folur me vështirësi dhe rëndë e të kuptueshëm;
- Ka vështirësi në tërheqjen e vëmendjes;
- Ka vështirësi në të kuptuarit e informatave të prezentuara vetëm me tekst etj.

Patjetër duhet të theksohet se vet nxënësi do t'ju drejtojë si ta përdorni më mirë kompjuterin. Duke i ndjekur vështirësitë dhe aftësitë e tij do të merni udhëzime në çfarë mënyre, me çfarë intenziteti dhe në cilat aktivitete kompjuteri do e lehtësojë përcjelljen e mësimit. Nuk ka rregulla precize dhe të sakta, më saktësisht, përdorimi i kompjuterit te nxënës me aftësi apo vështirësi të ngjashme, mundet në masë të madhe të ndryshojë në krahasim me përfshirjen dhe efektet prej përdorimit të kompjuterit.

Si do të kontribuojë kompjuteri në arritjen e qëllimeve prej planit ndividual arsimor?

Gjithnjë kur keni mundësi ta përdorni kompjuterin në mësim me nxënës/ nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, më mirë do të jetë ta keni paraparë në planin individual arsimor, sepse në atë mënyrë do të mund ta planifikoni përdorimin e kompjuterit për të arritur dhe monitoruar qëllimet.

Plani individual arsimor, le të mos u shkaktojë vështirësi sepse ai do të jetë drejtim i mirë për planifikimin e aktiviteteve dhe të monitorimit të të arriturave të nxënësit. Kompjuteri mund t'u jetë vegël që do t'u ndihmojë gjatë notimit të nxënësit në fund të vitit shkollor.

Fotografia 2. Teknologjia ndihmëse në klasë

Për këtë arsye, gjithnjë kur përdorni kompjuter për punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, keni parasysh:

- Përdorimi i kompjuterit të jetë në funkcion për arritjen e një qëllimi të caktuar;
- Gjithmonë regjistroni kur e keni përdorur kompjuterin dhe për çfarë qëllimi;
- Përcilleni përdorimin e kompjuterit nga nxënësi dhe regjistroni ndryshimet që shprehen te ai;
- Evidentoni çdo ndryshim që mund t'u jep udhëzime për planifikimin e ardhshëm për punë me;
- Gjithnjë planifikoni kohë më të gjatë për arritjen e qëllimit të caktuar;
- Shfrytëzoni më shumë mënyra për prezentim të informatave (tekst, ilustrim, fotografi, audio, video, prezantim);
- Gjithnjë ruani punimet në kompjuter, nëse keni mundësi një pjesë prej tyre edhe në formë të shtypur; në këtë mënyrë do të mund ta ndiqni progresin e nxënësit dhe të krijoni portfolio elektronike për nxënësin që do ti përmbajë të gjitha punimet kompjuterike;

- Kompjuterin ta keni parasysh edhe kur bëhet fjalë për vlerësimin e të arriturave, si p.sh. përgatitja e testit në formë elektronike.

Bashkëpunoni me prindërit dhe me bashkëpunëtorët profesional në shkollën tuaj, sepse ata mund të jenë ndihmesë e madhe gjatë përpilimit të planifkimeve, si dhe përgatitjet e aktiviteteve për nxënësin. Përveç nxënësit, prindërit gjithashtu mund tu ofrojnë informata që mund t'u ndihmojnë gjatë planifikimit të punës me kompjuter me nxënësin me Nevoja të veçanta arsimore.

Shokët e klasës, nëpërmjet pranimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes mund i ndihmojnë nxënësit me Nevoja të veçanta arsimore që më lehtë ta pranojë punën me kompjuter, më shpesh të merr pjesë në aktiitete gjatë orës së mësimit, si dhe të ndiejë më tepër vetbesim gjatë plotësimit dhe arritjes së qëllimeve mësimore. Në bashkëpunim me nxënësin, mund të kyçni edhe nxënës-mentor i cili do të jetë mbështetje për nxënësin me Nevoja të veçanta arsimore në aktivitete në të cilat has në vështirësi. Përfshirja e shokëve të klasës në planifikim, në realizimin dhe në monitorimin e të arriturave të nxënësit me Nevoja të veçanta arsimore , ofron kushte për klimë të mirë shkollore, si dhe mundësi për socijalizim dhe pranim të ndërsjellë.

1.2 TEKNOLOGJIA NDIHMËSE (HARDUERI DHE SOFTUERI)

Përdorimi i kompjuterit në punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore nuk është gjithnjë i mjaftueshëm. Për disa nxënës, kompjuteri mund të paraqes vështërisëi plotësuese për arsye të: lëvizjes së kufizuar të duarve, zhvillimit të dobët të motorikës, pamjes së dobët të përmbajtjtes së ekranit, përdorimit të njësive standarde hyrëse (mausi, tastiera) etj. Për këtë arsye, sot, teknologjia moderne e cila gjithnjë po përparon, ofron mundësi plotësuese të cilat e aftësojnë kompjuterin për aftësitë e personit që e përdor. Kjo do të thotë, se nuk duhet të kërkojmë kompjuter me ekran më të vogël ose më të madh, e tastierë më të vogël ose më të madhe, maus, por mund të bëhen rregullime të duhura në kompjuter[1], si dhe në mënyrë plotësuese të përdoren pajisje ndihmëse të cilat mund ta bëjnë kompjuterin të përdorshëm për persona me aftësi dhe vështirësi të ndryshme.

Teknologjia ndihmëse, që është një prej mënyrave të përshtatjes së kompjuterit, ofron mundësi për punë të pandërprerë të kompjuterit. Me teknologji ndihmëse, nënkuptohet çdo prodhim, pjesë e ndonjë pajisjeje apo sistemi pa marë parasysh a përdoret në formën origjinale burimore, i aftësuar apo i adaptuar që përdoret për ti zmadhuar, për ti mbajtur në nivel ose të përmirësohen aftësitëe funkcionale të personave me aftësi të kufizuara[2]. Teknologjia ndihmëse përfshin një spektër të gjerë të pajisjeve ndihmëse për lehtësimin e lëvizjes, komunikimit, punës me kmpjuter, aktiviteteve të përditshme, si dhe shërbime që u mundësojnë, personave me aftësi të kufizuara të kryejnë funkcione të cilat, në të kundërtën, do të ishin të vështira ose të parealizueshme.

Kur bëhet fjalë për përdorimin e kompjuterit, teknologjia ndihmëse përfshinë:

1 Për rregullime të mundshme në Edubuntu Linux mund të gjeni në Doracakun „Si ta bëni kompjuterin më të lehtë për punë - Opcione qasëse në Edubuntu Linux“

2 Enciklopedia për handikap, 2006, http://inkluzivno-obrazovanje.rs/primena-inkluzije/asistivne-tehnologije

Fotografia 3. Pajisje harduerike: trakboll, leva e adaptuar, klikim i ndarë dhe tastiera me taste të mdha

- pajisje harduerike (tastiera lternative – tastiera me taste të mëdha), pajisje për kontroll të mausit (lloje të ndryshme levash, trakboll, kontrollues), klikime të ndara, ekran me të prekur, tabela për komunikim etj.);
- Softuer (lexues i ekranit, llupa elektronike, softuer për kontroll të kompjuterit me anë të syve, përshtatje të ndryshme softuerike për ekran, tastiera, lëvizje e kontrolluesit etj.)

Fotografia 4. Softueri: lexues i ekranit JAWS, llupa elektronike dhe tastiera elektronike

V. T. Kavano (W T Cavanaugh) vë në dukje se sot, përdorimi i teknologjisë nëpërgjithësi, ofron mundësi të barabarta për të. Ai thotë se nëpërmjet përdorimit të teknologjisë ndihmëse, shumë nxënës me nevoja të veçanta arsimore munden ta zvoglojnë izolimin e tyre dhe të bëhen pjesë e rëndësishme e aktiviteteve në klasë. Sipas tij, teknologjia ndihmëse ka kapacitet ta zmadhojë pavarësinë e nxënësit, ta zmadhojë pjesëmarrjen në aktivitetet shkollore dhe në mënyrë simultane ti zmadhojë njohuritë akademike të nxënëit me nevoja të veçanta arsimore, duke i mundësuar qasje të barabartë në mjedisin shkollor.

SIpas M. E. Gold (M. E. Gold) dhe Ç. Lov (C. Lowe), teknologjia ndihmëse mund të ketë rol të madh në mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës (inkluziv). Ata thonë se në mesin e përfitimeve të shumta që i ofron teknologjia mbështetëse, padyshim, përfitim më

i madh është aftësia e teknologjisë ndihmëse, te nxënësi ta rris ndjenjën e pavarësisë dhe shkallën e qasjes te arsimi i rregullt dhe mjedisin e rregullt arsimor. Ajo që theksohet më tepër, është se teknologjia ndihmëse mund të jetë vegël e fuqishme në sigurimin e pavarësisë dhe garantim i gjithëpërfshirjes (inkluzionit) në arsimin e rregullt.

Lidhur me rëndësinë dhe rolin e teknologjisë ndihmëse në arsim si përgatitja e arsitarëve për praktikat gjithëpërfshirëse, Kavano vëren se teknologjia ndihmëse është vegël edukative gjithëpërfshirëse që rritet gjithnjë e më shumë përdorimi i saj. Ai thotë se teknologjia ndihmëse gjithnjë duhet të merret parasysh për çdo nxënës me nevoja të veçanta arsimore, ajo duhet të jetë e përfshirë në planin individual arsimor si vegël që mundëson qasje te infromacionet dhe aktivitetet që janë të pamundura në mënyrë tjetër.

Deri para dise viteve, teknologjia ndihmëse, si mundësi për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore as që përmendej, edhepse procesi i kompjuterizimit i përfshiu të gjitha shkollat fillore. Të gjithë shkollat fillore në shtetin tonë u pajisln me kompjuterë, por për fat të keq, për një numër nxënësish me nevoja të veçanta arsimore , kompjuterizimi paraqiste vështirësi shtesë me të cilat do ballafaqohen gjatë procesit mësimor.

Me qëllim të kontribuohet për përmirësimin e praktikës gjithëpërfshirëse në mësimin e rregullt, Projekti i USAID-it për arsimin e-përfshirës, i cili prej vitit 2010 deri në vitin 2012 u realizua nga organizata "Hapni dritaret", në periudhën kohore prej 2012 deri në vitin 2012 përfshiu teknologjinë ndihmëse në 21 shkolla fillore në gjithë shtetin, dhe mundësoi:

- më shumë se 200 nxënës të kenë mundësi tëpërdorin teknologji ndihmëse gjatë mësimit, si dhe
- më shumë se 300 arsimtarë të aplikojnë metoda të reja në punën e tyre duke përdorur teknologji ndihmëse në mësim.[3]

Në periudhën që pason, aktivitetet e organizatës "Hapni dritaret" në suaza të Projektit të USAID-it për e-përfshirje të mësimit, do të përfshijnë 31 shkolla fillore, të cilët nëpërmjet përvojave të tyre praktike d të kontribuojnë për promovimin e teknologjisë ndihmëse në arsimin fillor në Maqedoni.

3 Më tepër informata për aktivitetet në suazat e Projektit të USAID-it për e-përfshirjen e mësimit, mund të gjeni në publikimin "Teknologjia informatike ndihmëse për gjithëpërfshirje më të madhe në arsim: analia dhe rekomandime", „Hapni dritaret", 2012

Fotografia 5. Teknologjia ndihmëse në arsimin fillor

Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në mësim me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore mund të jetë shumë i dobishëm si vegël e cila do ta përkrahë procesin e përcjelljes së mësimit, pjesëmarrje gjatë orës së mësimit, si dhe mundësi për përcjellje dhe evaluim të arriturave të nxënësit.

Në procesin e përcjelljes së mësimit, teknologjia ndihmëse mund të gjejë aplikim në rastet:

- kur nxënësi, përshkak vështirësive të motorikës së duarve nuk mund të përdorë laps dhe fletore, por me ndihmën e tastierës me taste të mëdha dhe me trakboll, apo me levë (xhojstik) mund të shprehet me shkrim në kompjuter; të shkruaj plan për punë prej tabelës, të përgjigjet në pyetjet e parashtruara etj.;
- kur nxënësi ka vështirësi me të folurit, shprehet me vështirësi, mendimet e tij mundet ti shprehë me shkrim nëpërmjet kompjuterit, dhe pas kësaj me ndihmën e lexuesit të ekranit të kompjuterit ta lexojë atë që e ka skruar nxënësi;
- për nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale, ofroni lidhëshmëri të informatës me ilustrime konkrete, me animacione, me video në kompjuter etj.;

- për nxënës me vështirësi në ta pmaurit, përdorni materijale mësimore me font të zmadhuar shkronjash ose llupën elektronike që e zmadhon përmbajtjen në ekran.

Gjatë orë së mësimit, me qëllim që ta nxitni nxënësin me nevoja të veçanta arsimore të jetë më shumë aktiv dhe të merr pjesë më shumë në aktivitete, mundeni:

- të përdorni softuer edukativ për temën e dhënë;
- të kërkoni të krijojë prezantim për temën që punohet brenda orës së mësimit dhe ta prezantojë para nxënësve të klasës (nëse tema është prej tyre që më vështirë përvetëohet, mund ta përgatis sëbashku me ndonjë prej shokëve të klasës);
- të kërkoni fotografi, ilustrime për tema të dhëna dhe ti shfaqë para nxënësve tjerë të klasës etj.

Regjistroni ndryshimet që paraqiten te nxënësi me përdorimin e kompjuterit dhe të teknologjisë ndihmëse edhe pa përdorimin e tyre, që të mund të bëni diferencim dhe ta dokumentoni progresin. Kjo do të jetë mundësi për monitorim dhe evaluim të arriturave të nxënësit. Gjatë monitorimit të nxënësit dhe evaluimit të arriturave të tij/ saj, kompjuteri dhe teknologjia ndihmëse mund t'u ndihmojë gjatë:

- përdorimit të testeve elektronike,si p.sh. nëse nxënësi ka vështirësi gjatë lëvizjes së duarve dhe vështirësi në të shkruajtur me laps, me ndihmën e teknologjisë ndihmëse mund ta punojë testin në kompjuter;
- ruajtjes së punimeve kompjuterike (teste, përgjigje në detyrat e dhëna) që do ta tregojnë progresin e nxënësit;
- punimit të detyrave shkollore dhe atyre shtëpiake etj.

Teknologjinë ndihmëse që do ta përdorni gjatë punës me nxënësin me Nevoja të veçanta arsimore duhet t'i përgigjet nevojave të nxënësit dhe ti mundësojë ose mbështes aktivitetet që i krijojnë vështirësi. Gjithnjë duhet ti keni parasysh mundësitë e nxënësit, vështirësitë me të cilat ballafaqohet, rrethina dhe detyrat që ia jepni, të gjitha këto me qëllim që t'i mundësoni pjesëmarrje aktive gjatë orës së mësimit.

Edhe pse në pamje të parë, përdorimi i teknologjisë ndihmëse mund të duket se ua vështirëson punën dhe se do të jetë obligim plotësues, megjithatë keni parasysh se përfitimet që i ofron teknologjia ndihmëse mund të jenë afatgjate.

Prandaj, keni parasysh se përdorimi i teknologjisë ndihmëse në mësim është e kushtëzuar prej parakushteve në vijim:

- nxënësi dhe arsimtari kanë informata të mjaftueshme për teknologjinë ndihmëse;
- nxënësi dhe arsimtari janë të trajnuar për përdorimin e saj;
- plan i përgatitur për përdorimin e teknologjisë ndihmëse;
- pajisjet janë të dukshme dhe gjithnjë në dispozicion;
- për pajisjet ka mbështetje të nevojshme teknike dhe servisim;
- ekziston bashkëpunimi me prindërit, arsimtarët dhe me shërbimin profesional;
- janë të bashkangjitur moshatarë gjatë përdorimit të teknologjisë ndihmëse.[4]

4 Gold E M, Lowe C, The Integration of Assistive Technology into Standard Classroom Practices: Practical Recommendation for K-12 General Education, Austion Peay State University

1.3 PËRCJELLJA E PËRFITIMEVE NGA PËRDORIMI I KOMPJUTERIT DHE TEKNOLOGJISË NDIHMËSE

Gjatë planifikimit të përdorimit të kompjuterit dhe të teknologjisë ndihmëse, gjithnjë i dobishëm do të jetë konsultimi me nxënësin që do ti përdorë ato, ekipi profesional dhe prindërit. Ata mund t'u ndihmojnë gjatë sigurimit të informatave të nevojshme të cilat do t'u shërbejnë për të bërë zgjedhje të mirë në përdorimin e kompjuterit dhe të teknologjisë ndihmëse.

Gjithnjë kur përdorni teknologji ndihmëse, dokumentoni se çka keni shfrytëzuar, sa kohë dhe për çfarë qëllimi e keni përdorur teknologjinë ndihmëse, pa marrë parasysh a keni përdoru harduer ose softuer. Evidentoni::

- Nxënësi a e pranon teknologjinë ndihmëse;
- Në çfarë mënyre e përdor;
- Si ka qenë pjesëmarrja e nxënësit në aktivitete të caktuara gjatë orës së mësimit;
- Si ka qenë plotësimi i kërkesave të dhëna nga arsimtari, në krahasim me shpejtësinë, kualitetin e punës, saktësinë e aktiviteteit, suksesi etj.;
- Sa ka pasur ndikim teknologjia ndihmëse në rritjen dhe pavarësimin e nxënësit në aktivitete të caktuara;
- Si është kënaqësia nga ana e nxënësit, dhe
- Gjithçka që mendoni se si informatë do t'ju ndihmojë në punën e mëtutjeshme me nxënësin.

Dokumentimi i përdorimit të teknologjisë ndihmëse do t'ju sigurojë informata për përfitimet prej përdorimit, si dhe të dhëna që i përkasin të arriturave të nxënësit, por edhe informata për aftësitë e tij të cilat do t'ju ndihmojnë për planifikimin e aktiviteteve të mëtejme të cilat do të jenë në drejtim të arriturave të qëllimeve arsimore të përdoruesit.

Përcjellja e të arriturave, do t'ju ndihmojë ti analizoni të arriturat e nxënësit, ti identifikoni vështirësitë me të cilat ndeshet, si dhe ta vëreni nevojën e mbështetjes plotësuese për arritjen e njohurive dhe shkathtësive të caktuara.

Informatat që do ti merni prejmonitorimit, nëse është e nevojshme do t'ju ndihmojnë ta rishikoni planin individual arsimor (PIA) të nxënësit, të bëni ndryshime në mënyrën e prezantimit të njësisë, mënyrën e vlerësimit të njohurive, resurset e nevojshme etj.

Veçanërisht e rëndësishme për informatat që do ti keni pas një kohe të caktuar është shkëmbimi i tyre me nxënësin, me prindërit e tij, me shërbimin profesional dhe të mundësoni komunikim dhe bashkëpunim të përhershëm.

2 PËRSHTATJA E MATERIJALEVE QË PËRDOREN NË MËSIM

Përshtatja e materijaleve që i përdorni në mësim me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nxënësit do ti mundësojë përfshirje të suksesshme në aktivitetet e orës mësimore.

Gjithnjë, kur i përgatisni materijalet që do ti përdorni gjatë orës së mësimit, duhet ti keni parasysh aftësitë e nxënësit dhe vështirësitë me të cilat ndeshet, me qëllim që të përgatisni materiale përshtatëse adekuate.

V. V. Kavano (W T Cavanaugh) vë në dukje se edukatorët duhet të jenë të përgatitur për ta adaptuar materijalin arsimor, të bëjnë ndryshime të duhura ose ta përshtatin në mënyër që të jetë e kapshme për nxënëin dhe ti mundësohet nxënësit të ketë qasje deri te ato materiale.

Përshtatja e materijaleve, në fillim mund tju duket si gjë për të cilën do t'ju duhet shumë kohë, shumë dituri ose për kërkim të ndihmës, por duke e përcjellur nxënëin tuaj, duke i vërejtur aftësitë por edhe vështirësitë me tëcilat ndeshet, përvoja juaj mund tju jep shumë ndihmë në aspekt të asaj se çfarë përshtatjesh të materijaeve duhet bërë me qëllim që nxënësi me nevoja të veçanta arsimore në mënyrë aktive të jetë i kyçur gjatë orës së mësimit.

Përshtatjen e materialeve duhet patur parasysh edhe gjatë përdorimit të atyre elektronike apo të shtypur.

Shembulli 1. **Në klasë keni nxënës me dëmtim të të pamurit dhe me vështirësi gjatë leximit të tekstit me font më të vogël të shkronjave (p.sh. tesktet nga libri ose të fletës së punës).Materijalet që i përdorni gjatë orës së mësimit, pa marrë parasysh a janë të shtypur ose elektronik, duhet të jenë me font më të madh prej atij fonti që punoni me nxënësit tjerë (dëmtimet në të pamurit kërkojnë font më të madh të shkronjave) edhe me kontrast më të fortë (më mirë do të ishte që shronjat të jenë të zeza ndërsa siprfqja (sfondi) i bardhë). Në këtë mënyrë do të mundësoni që nxënësi me dëmtime në të pamurit ti kryejë detyrat njëkohësisht me nxënësit tjerë, në të kundërtën do ti duhet ndihma juaj ose e ndonjë shoku ë klasë.**

Shebulli 2. Në klasë keni nxënës me dëmtim të të dëgjuarit. Pas përpunimit të ndonjë teme mësimore, nxënësve u jepni detyrë verbale (gojore) për të kryer ndonjë detyrë të caktuar. Me qëllim që edhe nxënësi me dëmtim të dëgjuarit me kohë ta merr urdhrin për ta kryer detyrën me nxënësit tjerë njëkohësisht dhe në mënyrë të barabrtë , gjithnjë duhet të keni të përgatitur edhe detyrë me shkrim.

2.1 REKOMANDIME PËR PËRSHTATJEN E MATERIJALEVE MËSIMORE

Gjithnjë kur përdorni materijale mësimore, keni parasysh sa do të jenë ato në dispozicion të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasën tuaj, në çfarë mase do të vij deri te informacioni që do ta shkëmbeni, sa do të jetë e kuptueshme njësia mësimore për nxënësin dhe, materijali sa do të mundësojë aktivitet dhe pavarësi për nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.

Gjatë përgatitjes së materijaleve, nëse keni nxënës me nevoja të veçanta arsimore , sipas aftësive dhe vështirësive, duhet ti keni parasysh përshtatjet që duhet bërë rreth përmbajtjes, ilustrimeve/ fotografive dhe mënyrës së prezantimit.

PËRMBAJTJA

Fontet (pamja e shkronjave). Përdorimi i fontit mund të ndikojë në mundësinë që leximi të jetë i lehtë ose i vështirë në dokument. Duhet përdorur font që është lehtë i lexueshëm, font i cili nuk ka pjesë shtesë që e vështirëson leximin. Fonti duhet të jetë cirilik apo sipas nevojës së gjuhës që përdoret

- Në një dokument, mirë është ti shmangeni përdorimit të më shumë fonteve, sepse në atë mënyrë do ta vështirësoni leximin e përmbajtjes së dokumentit.
- Në një tekst, shmangni përdorimin e shumtë të karakteristikave plotësuese sç janë: trashësia e shkronjave, shkronjst kurzive, nënvizimi i shkronjave apo i tekstit etj.
- Leni hapësirë të nevojshme (të duhur) në mes fjalëve në fjali.

Rekomandim: Përdorni fontin **Arial** në vend të **Times New Roman**.

Madhësia e shkronjave. Kur e përgadisni dokumentin, gjithnjë keni parasysh madhësinë e shkronjave që do ta përdorni gjatë shkruarjes së tekstit: shkronjat mos të jenë të vogla ose shumë të mëdha, sepse kjo mund të ndikojë në edhe në pamjen por edhe në lexueshmërinë e dokumentit.

- Shmanguni që në një dokument të përdorni pjesë me madhësi të ndryshme, ose pjesë që janë shkruar me shkronja shumë të vogla ose me shkronja shumë të mëdha.

Rekomandim: Përdorni madhësi të shkronjave ndërmjet 12 dhe 16 pointa.

Përdorimi i ngjyrës, kontrasti. Me qëllim të mundësimit të leximit të qartë dhe të pastër të dokumentit, gjatë përgatitjes keni parasysh kontrastin ndërmet ngjyrës së shkronjës dhe sfondit (prapavijës) së faqes.

- Gjithnjë duhet të ketë kontrast adekuat ndërmjet shkronjave dhe të sfondit (prapavijës) të dokumentit.
- Shmangjuni përdorimit të sfondit me disejn të ndryshëm, i cili edhepse kontrasti mund të jetë adekuat, do të ndikojë edhe në leximin e pastër por edhe në aspektin estetik.

Rekomandim: mënyra standarde është përdorimi i shkronjave me ngjyrë të zezë në prapavijë (sfond) të bardhë, por **gjithnjë** keni parasysh **karakteristikat individuale** të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Përgatitje e përmbajtjes. Gjatë përgatitjes se përmbajtjtes së dokumentit, keni parasysh:

- Informatat të jenë konkrete, të qarta dhe të lexueshme.
- Kur keni nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale ose me vështirësi gjatë leximit, përdorni fjali të shkurtra dhe të qarta.
- Nëse është e nevojshme, ofron më pak informata në dokument.
- Mundësoni hapësirë të mjaftueshme për tekstin.
- Dokumentin ta tsrukturoni mirë (të theksohet mirë titulli dhe përmbajtja e tekstit).

ILUSTRIMET/FOTOGRAFITË

Gjithnjë kur keni mundësi, përdorni ilustrime/ fotografi me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së informatës që doni ta shkëmbeni dhe në këtë mënyrë do të mundësoni që nxënësi më lehtë ta kuptojë përmbajtjen e tekstit.

- Kur përdorni ilustrim/ fotografi, keni parasysh që ajo të paraqes ndonjë ide, aktivitet apo një mendim të caktuar dhe të qartë.

- Ilustrimi/ fotografia që e përdorni, duhet të jetë e rëndomtë, e thjeshtë dhe e qartë, pa ndonjë informatë shtesë të mbingarkuar, por me kontrast të mirë të ngjyrnave.
- Gjithnjë, emërtojeni atë që është e paraqitur në ilustrim apo fotografi.
- Mos përdorni (vëndoni, shkruani) tekst mbi ilustrimin apo fotografinë.
- Ilustrimi/ fotografia duhet të ketë vend të qartë në dokument dhe ta ndjek përmbajtjten e tekstit (të jetë në përputhshmëri).

MËNYRA E PREZANTIMIT

Kur i punoni (përgadisni) përgatitjet ditore për orë të mësimit, gjithnjë duhet të keni parasysh përmbajtjten dhe mënyrën e prezantimit të infomatave që duhet të arrijnë te sa më shumë nxënës Gjithnjë kur keni mundësi, përdorni mënyra të shumta të prezantimit të përmbajtjeve mësimore, si: .

- tekst
- fotografi
- ilustrim
- animacion
- video
- audio
- prezantim kompjuterik etj.

Shpesh herë mund të gjendeni në situatë kur nxënësi me nevoja të veçanta arsimore ballafaqohet me vështirësi për ta kuptuar përmbajtjen mësimore, për këtë arsye, shumë me rëndësi është që të përdorni mënyra të ndryshme të prezantimit me të vetmin qëllim që informata të arrijë te nxënësi në mënyrë të lehtë dhe të qartë dhe të jetë e kuptueshme. Gjithashtu, mund t'u rekomandoni prindërve për ndonjë temë të caktuar të përdorin animacione dhe video të ndryshme (adekuate) në shtëpitë e tyre, me qëllim të përsëritjes së atyre informatave (njësive) që i kanë punuar në shkollë.

Rekomandimet e dhëna më lart gjithnjë ti keni parasysh kur përdorni materijale elektronike për punë, të cilët, gjithashtu, nëse nuk janë të përshtatur sipas aftësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore,

mundësia që ato të jenë të kuptueshme dhe të përdorshme, do të jetë sumë e vogël.

Nëse keni nevojë për ndihmë lidhur me nivelin dhe mënyrën e përshtatjes së materijaleve për punë, konsultohuni me prindërit e nxënësve, me shërbimet profesionale, me njerëz profesional apo organizata që merren me këtë problematikë. Të cilët mund t'ju ofrojnë informata të cilat do t'u ndihmojnë në përshtatjen e materijaleve për nevojat tuaja në procesin e mësimit.

Në drejtim të individualizimit të mësimit, keni parasysh se:

- Nuk ka zgjidhje të vetme (univerzale) për përshtatjet e materijaleve apo të punëve.
- Përshtatja adekuate, varet prej: nxënësit, llojit të nevojave të veçanta arsimore personale, resurset (burimet) që i shfrytëzoni, qëllimet mësimore dhe përdorimi i informatave.
- Përshtatjet të cilat do tu marrin shumë kohë dhe që krkojnë shumë resurse, nuk do të thotë se edhe do të jene më efektive. Ndonjëherë janë shumë të rndomta, të thjeshta ato përshtatje dhe mund të fitoni informatë kthyese prej nxënësit më shumë se sa keni pritur.
- Në bisedë me nxënësin, mund të fitoni ide prej një spektri shumë të gjerë për përshtatje të mundshme që do tu shërbejnë gjatë punës sëmëtutjeshme me nxënësit.

Click to add title

3

SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE KOMPJUTERIKE

Me qëllim që t'ju ofrojmë informata konkrete dhe rekomandime që mund të gjejnë aplikim në punën tuaj me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, në këtë pjesë të doracakut do t'ju prezentojmë përvoja nga ekipi profesional i "Hapni dritaret" gjatë punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, si dhe përvoja të arsimtarëve që patën mundësi, në suaza të Projektit të USAID-it për arsimin e-përfshirës, të përdorin teknologjinë ndihmëse.

Nëpërmjet praktikave gjithëpërfshirëse kompjuterike, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore kanë mundësi që në mënyrë aktive të përfshihen (kyçen) në procesin mësimor, të marin pjesë aktive gjatë orës së mësimit si dhe të kenë mundësi më të shumta për përfitimin e njohurive në mësim.

Aplikimi dhe përfshirja e kompjuterit dhe i teknologjisë ndihmëse në mësim është shumë i madh. Arsimtarëve u mundëson spektër të gjerë aktivitetesh të cilat mund ti realizojnë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe për përmbajtje të ndryshme mësimore, përdorim i metodave të reja në punë, klimë më të mirë gjithëpërfshirëse etj. Nga ana tjetër, për disa nxënës, përdorimi i kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse është mundësia e vetme për pjesëmarrje aktive në orë të mësimit, kyçje në aktivitet mësimore si dhe ritregim të njohurive të fituara.

Duke u nisur prej aftësive dhe vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasën tuaj, panifikoni dhe përfshini në punë kompjuterin ose tekologjinë ndihmëse në ato aktivitete për të cilat nxënësi ka nevojë mbështetje plotësuese gjatë përcjelljes së mësimit apo gjatë vlerësimit të njohurive të fituara.

Në pjesën që pason, do të keni mundësi të lexoni pesë shembuj nga praktikimi i kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse nga puna praktike e ekipit profesional të Qendrës për teknologji ndihmëse pranë organizatës "Hapni dritaret", si dhe 25 shembuj prej 11 shkollave. Arsimtarët dhe shkollat ishin të përfshirë në fazën e parë të Projektit të

USAID-it për arsim e-përfshirës dhe fituan teknologji ndihmëse si dhe trajnim për përdorimin e tyre.

Sinqerisht, shpresoj se praktikat kompjuterike gjithëpërfshirëse të cilat do të keni mundësi ti shihni në këtë doracak, do tu shërbejnë si ide për realizimin e përmbajtjes mësimore dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë për mbështetje të procesit mësimor të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Shembujt praktik janë prezantuar në format që u është propozuar arsimtarëve nga vetë autori, a që është përgatitur sipas përvojave të ekipit të "Hapni dritaret" në konsultim me arsimtarët. **Formati** përmban disa udhëzime, me qëllim të planifikimit më të lehtë të aktiviteteve kompjuterike për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Ai nuk paraqet formë të definuar, dhe mund të përshtatet sipas përvojës, të aplikimit dhe nevojave.

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me NVA (nevoja të veçanta arsimore). Përshkrim i asaj se çka mund të punojë nxënësi nënyrë të pavarur, me ndihmë të vogël nga arsimtari apo bashkënxënësi, ajo që has në vështirësi më të mëdha gjatë përcjelljes së mësimit, pjeëmarrje në orë të mësimit dhe arritja e qëllimeve.

Qëllim i aktivitetit. Qëllimi që duhet të arrihet me aktivitetin që realizohet; qëllimi prej planit individual arsimor të nxënësit; qëllimi që dedikohet në të kuptuarit, të mbajturit mend, reprodukim, aplikim i përmbajtjes, zhvillim i personalitetit, akivitet në orë, motivim i nxënësit etj.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Përshkrim i aktivitetit, mënyra e realizimit të aktivitetit, metodat dhe format e punës, përdorimi i fletëzave mësimore etj. Përshkrim i bashkëpunimit me nxënësin.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqet e shfrytëzuara). Në çfarë mase është përdorur kompjuteri, programet kompjuterike të përdoru nga ana e nxënësit, përdorimi i teknologjisë ndihmëse, linqe të internetit që janë përdorur gjatë aktivitetit etj.

Përfitimet për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitime që paraqiten te nxënësi pas realizimit të aktivitetit, si dhe niveli i arritjes së qëllimeve të parapara sipas udhëzimeve të mësipërme.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Në çfarë mase dhe në ç'mënyrë ka pasur bashkangjitje të bashkënxënësve, të prindërve, të arsimtarëve tjerë dhe profileve profesionale në reaizimin e aktivitetit.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Pamje për aplikimin e shembullit praktik për lëndë tjera mësimore, përmbajtje mësimore, d.m.th. aktiviteti që është theksuar, në çfarë forme mund të aplikohet.

3.1

SHEMBUJ PRAKTIK

PËR PËRDORIMIN E KOMPJUTERIT DHE TEKNOLOGJISË NDIHMËSE ME PËRDORUES NË QENDRËN PËR TEKNOLOGJI NDIHMËSE TË „HAPNI DRITARET“

Titulli i aktivitetit: Emërtimi dhe njohja e koncepteve dhe i objekteve

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Përdoruesi, në mënyrë të shkëlqyeshme e përdor dorën e majtë dhe pjesërisht i dallon objektet rreth tij. Është komunikativ dhe gjithnjë kërkon informata dhe shpjegim për atë që na rrethon. Si rezultat i hemiparezës në anën e djathtë, lëvizja e dorës së kësaj ane është e kufizuar. Dëmtimi i të pamurit (si rezultat i kataraktës që prej lindjes) dhe aftësitë e reduktuara vizuele (pamje e dobësuar) e kufizojnë përceptimin e objekteve që janë me dimensione më të vogla, që nga ana tjetër rezulton në njohjen e numrit më të vogël të koncepteve dhe objekteve nga jeta e përditshme.

Qëllimi i aktivitetit:

- përfitim i njohurive për punë me kompjuter dhe përdorimi i tij;
- zhvillim i aftësive kognitive nëpërmjet lojërave edukative;
- mbajtja dhe dorientimi i vëmendjes;
- zhvillim i koordinimit viziomotorik;
- zhvillim i percepcionit vizual;
- nxitje e komunikimit, korrigjim i të folurit dhe pasurimi i fondit verbal.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Dëmtimi i të pamurit dhe dobësimi i aftësive vizuale, imponuan nevojën për krijimin e përmbajtjeve individuale të përshtatura në drejtim të madhësisë dhe të kontrastit. Gjatë sesioneve të para, vumë re se përdoruesi atë që e seh nuk mundet në mënyrë adekuate ta emërtojë.

Aktiviteti **Emërtimi dhe njohja e koncepteve dhe i objekteve** punohej në tema të caktuara. Mënyra e punës ishte indidivuale.

Tema e parë, me përmbajtje të adaptuara, të cilën, përdoruesi e punoi ishte "Trupi im. Për këtë qëllim u përgatitën prezantime me programin PowerPoint dhe përmbajtje të krijuara me softuerin Smart. Përmbajtjet mësimore, në fillim i përpunuam në kontrast bardhë e zi. Në ekran, në sfond (prapvijë) të bardhë shfaqeshin materijaet një nga një. Pasi kuptohej përmbajtja që shihej kalohej në prezantimin e tij por tani me ngjyrë. Përdoruesi shumë shpejt i kuptonte, i njihte dhe i emërtonte pjesët e trupit me emrin përkatës. Pas secilës përmbajtje që ofron në mënyrë vizuele të kuptohen konceptet, me përdoruesin kalohej në ushtrime edukative të punuara në Power point ose me suftuerin Smart. Lojërat përmbanin aktivitete që kërkonin prej përdoruesit të rrethojnë objektin përkatës (syri, hunda, veshi), të bëjë lidhjen e dy pjesëve të trupit, ta vendos pjesën e trupit në vendin përkatës të punimit, ti numërojë...Përdorej softueri edukativ Show me. Qëllimi i këtyre lojërave është të kontrollohen njohuritë

nga prezantimi, por edhe të ushtrohet perceptimi vizual i sendeve, koordinimi viziomotorik si dhe motorika në përgjithësi.

Përmbajtja tjetër e adaptuar përfshinte njohjen e koncepeve nga tema „Veshja". Mënyra e punës ishte e njëjtë si në temën e mëparshëme. Pasi i zotëroi konceptet e ofruara në këtë temë, përdoruesi tanimë në mënyrë të pavarur mund të përshkruaj fotografi në të cilën është përfshirë një apo më shumë fëmijë (t'i tregojë pjesët e trupit dhe të trgojë se me çka janë të veshur). Ushtrimet e adaptuara përmbanin fotografi pa shumë detaje (kishim kujdes që fotografitë të kenë koncepte që i ka në dispozicion edhe përdoruesi). Ushtrimet i përfshijnë ngjyrat elementare, dhe mbi ta mësohen dhe ushtrohen ngjyrat tjera. Njohja e ngjyrave dhe përvetësimi i koncepteve mundësuan edhe zhvillimin e aftësive për klasifikim. Suksesin te përdoruesi e nxiste dëshira për përvetësimin e koncepteve të reja

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqet e shfrytëzuara).

Përdoruesi shfrytëzon ekran me të prekur. Gjithashtu, për të arritur objektivat, u përdor softueri edukativ Show me, prezantime të adaptuara në Power point dhe përmbajtje të krijuara me softuerin Smart.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve:

- njohuri tëfituara për punë me kompjuter;
- njohuri më të qëndrueshme;
- zhvillim që nxit aftësitë kognitive;
- koordinimi viziomotorik dhe motorik janë të përmirësuar;
- fond i pasuruar me koncepte.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Përfshirja e prindërve (në kushte shtëpiake praktikisht prezentohen dhe ndërrohen sendet dhe konceptet që i mësuan nëpërmjet këtij aktiviteti).

Zbatueshmëria e aktivitetit. Zotërimi i koncepteve të këtij atviteti, mundësuan zhvillim të aftësive për klasifikim, që praktikisht mund të shfrytëzohet për të mësuar kuptimin për numrin. Në kushte shtëpiake, përdoruesi tregon interes në zgjedhjen e rrobave për veshje. Komunikimi dhe fondi verbal është në nivel më të lartë.

[Aktivitetin e ka realizuar Marija Velinkovska, defektologe pranë “Hapni dritaret”.]

Titulli i aktivitetit: Monomet dhe polinomet



Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Përdoruesi te i cili, shkathtësitë matematikore janë në nivel konkret, shkëlqyeshëm shërbehet me kalkulator gjatë operacioneve më të ndërlikuara matematikore, të cilat, në të kundërtën i shkaktojnë vështirësi më të mëdha.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i aktivitetit është q përdoruesi ta ushtrojë programin për prezantim dhe të merr pjesë në orën e mësimit nga matematika në të cilën përpunohet tema për monomet de polinomet

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në bashkëpunim me përdoruesin, me prindin dhe arsimtarin e matematikës, ramë dakord që përdoruesi të krijojë prezantim me temë **Monomet dhe polinomet,** temë e cila për atë është abstrakte, por me qëllim që të merr pjesë në orë të mësimit, duke marrë parasysh shkathtësitë e tij kompjuterike bashkënxënësit e tij do ta përsërisin temën mësimore.

Me ndihmë të vogël në përgatitjen e prezantimit, përdoruesi, në disa sesione i regjistroi informatat që i mori nga arsimtari. Në orën e planifikuar, sëbashku me arsitarin, përdoruesi e prezantoi punimin e tij i cili i ndihmoi arsimtarit por edhe nxënësve që ta përsërisin temën.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqet e shfrytëzuara):

- tastiera me shkronja cirilike;
- përshtatje e ekranit (ikona të zmadhuara, kursori i zmadhuar, sipërfaqe e rëndomtë pune);
- program për prezantime.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përdoruesi, në mënyrë më të pavarur e përdor programin për prezantime, merr pjesë aktive në orën e mësimit dhe i përmirësoi shkathtësitë e tij për prezantime.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Prindërit u bashkangjitën në atë mënyrë që bashkërisht e ushtruan prezantimin në shtëpitë e tyre.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktivitet të këtillë mund të aplikoni për njësi mësimore në të cilat nxënësi has në vështirësi më të mëdha për ta kuptuar përmbajtjen mësimore. Bashkëpunimi dhe përfshirja e prindërve dhe bashkënxënsve mund t'ju ndihmojë shumë gjatë realizimit të orës.

[Aktivitetin e realizoi Magdalena Dimkova-Velevska, defektologe në "Hapni dritaret".]

Titulli i aktivitetit: Kohët e foljes

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Përdorues me paralizë cerebrale që ka vështirësi gjatë të shkruajturit në mënyrën standarde.

Qëllimi i aktivitetit. Përfitim i njohurive për kohët e foljes; aplikim praktik i njohurive të fituara; mbështetje gjatë procesit të të shkruajturit; zhvillim i motorikës dhe koordinimit viziomotorik; nxitje të vetbesimit.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në pjesën hyrëse të aktivitetit, me përdoruesin bëhet fjalë për kohët e foljes (e tashme, e kryer dhe e ardhme) dhe me shembuj personal praktik sqarohen dallimet në mes tyre (p.sh. kur isha i vogël shkoja në çerdhe; Tani shkoj në shkollë; Kur do të rritem do të shkoj në fakultet). Pas kësaj pjese, përdoruesi gojarisht i ndryshon foljet që i thotë arsimtari në tri kohët e foljes.

Në pjesën kryesore të aktivitetit, përdoruesi me ndihmën e edukatorit hap dokument të ri dhe i përdor veglat për krijimin e tabelave që përbëhet prej tri kolonave dhe secila prej tyre përmban kohë të ndryshme të foljes. Pas kësaj, edukatori shkruan disa fjali dhe prej përdoruesit kërkon që ti gjejë kohët e foljeeve në ta dhe ti regjistrojë në ato kolona ku duhet. Që të arrihet komunikim dhe interakcion më i mirë, përdoruesi mendon disa fjali dhe kërkon prej defektologut që këto ti paraqesë në kohë të ndryshme të foljeve.

Në pjesën përfundimtare të aktivitetit, përdoruesi i ruan detyrat e punuara brenda orës në follder të caktuar dhe të nëjtat i shtyp. Nëse ka nevojë për sqarime plotësuese për temën e caktuar, kjo bëhet në këtë pjesë të orës.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqet e shfrytëzuara). Përdoruesi, në mënyrë të pavarur e përdor kompjuterin duke përdorur teknologjitë ndihmëse trakboll, klikime të ndara dhe tastirën me taste të mëdha. Prej programeve, e përdor Wordin për të shkruajtur.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve:

- më shpejtë, më lehtë dhe në mënyrë më interesante përfitohen njohuri të reja nga njësia mësimore;
- procesi i të shkruajturit është mbështetur mirë;
- rritje e vetbesimit;
- përdorimi i kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse bëhet në mënyrë të pavarur;
- mbështetje e procesit edukativo-arsimor.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale:

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktiviteti mund të jetë i zbatueshëm gjatë orëve mësimore nga gjuha maqedonase kur përpunohet dhe bëhet përsëritje e kësaj njësie mësimore.. Ushtrimet e dhëna mund të shfrytëzohen edhe për teste elektronike me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të cilët hasin në vështirësi në të shkruar në mënyrën standarde.

[Aktiviteti e ka realizuar Radmilla Stojkova-Aleksova, defektologe pranë "Hapni dritaret".]

Titulli i aktivitetit: Video „Viti Ri“

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe vështirësive të përdoruesit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Përdoruesja, me të cilën e përpunuam këtë video është e sëmurë prej paralizës celebrale. Ajo ka zhvillim normal intelektual, fond të pasur të fjalëve dhe është mjaft komunikative. Për shkak të dridhjes së theksuar ka vështirësi gjatë të shkruajturit me dorë, përkatësisht gjatë lëvizjes së lapsit dhe për këtë përdor kompjuterin si mjet për shkruarje. Është e pavarur gjatë punës me kompjuter, që do të thotë se nuk ka nevojë për mbështetje plotësuese. Detyrat e dhëna i kryen me kohë. Ka vështirësi gjatë të shprehurit dhe gjatë lëvizjes.

Qëllimi i aktivitetit:

- përgatitje e prezantimit në temë **„Viti Ri“;**
- përdoruesja të njihet me mënyrën e krijimit të videos me të cilën do të mund ta prezantojë atë që ka përvetësuar si njohur.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në fillim, zhvillojmë bisedë rreth Vitit të Ri dhe për dëshirat e saj për vitin që vjen. Pastaj, ajo në mënyrë të pavarur kërkoi fotografi në internet lidhur me temën e dhënë dhe të gjitha këto i ruajti për ti përdorur më vonë në video. Të gjitha i radhiti sipas radhës të parapërcaktuar. Futëm fotografi në vendet e duhura dhe përdoruesja shkruante nga ndonjë fjali lidhur me fotografitë. Në fillim të aktivitetit, përdoruesja kishte nevojë për ndihmë lidhur me futjen e fotografive, por sllajdet tjera arriti ti bëjë vetë. Videon që e krijoi, e prezantoi para nxënësve tjerë të shkollës gjatë orës së informatikës.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Këtë aktivitet e përpunuam me ndihmën e softuerit Windows Movie Maker. Gjatë kërkimit të fotografive të duhura, e përdorëm kërkuesin Google. Gjatë gjithë aktivitetit, përdoruesja e përdorte trakboll-in dhe tastierën me taste të mëdha. Gjatë të shkruajturit, i aktivizuam edhe "tastet kërcyese" të cilat mundësojnë që gjatë procesit të të shkruajturit ti shmangeni shkruarjes së shumë shkronjave përnjëherësh.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përdoruesja u njohtua me mënyrën dhe mundësië e krijmit të videos me anë të programit Movie Maker. Këtë program, përdoruesja do ta përdorë në të ardhmen për krijimin e videove lidhur me përmbajtjet mësimore në shkollë dhe për prezantimin e njohurive të saja të fituara gjatë këtyre aktiviteteve. Puna me këtë softuer i ndihmon në vetshprehjen e saj dhe kjo e bën shumë të lumtur dhe të kënaqur nga të arriturat e saj.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale

Zbatushmëria e aktivitetit. Puna në Windows Movie Maker gjen zbatueshmëri në mbështetjen e procesit edukativo-arsimore, sepse mund të shërbejë në krijimin e prezantimeve në një mënyrë tjetër dhe më ineteresante për përdoruesit.

[Aktivitetin e realizoi Aleksandra Spasovska, defektologe në "Hapni dritaret".]

Titulli i aktivitetit: artistët maqedonas

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Përdorues i cili e ndjek mësimin e rregullt, shkrim-këndim, ka fond të pasur fjalësh, në mënyrë të pavarur përdor kompjuter me shkronja cirilike dhe kërkon informata të duhura në internet. Vështirësi vërehen gjatë të shkruajturit me dorë (tekst i pakuptueshëm), vizatim, të kuptuarit e koncepteve abstrakte dhe përdorim i shkronjave latine.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i aktivitetit është që përdoruesi të pajiset me informata për artistët maqedonas në fushën e pikturës, në mënyrë të pavarur të kërkojë informata për piktorët maqedonas si dhe nxitjen e kreativitetit nëpërmjet prezantimit të përmbajtjes.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në bashkëpunim me përdoruesin dhe prindin, por me rekomandim prej arsimtarit të arsimit figurativ, u dakorduam të përgatisim një revistë që përmban informata për piktorët maqedonas, për shkak se përdoruesi balllafaqohet me vështirësi gjatë përpunimit të pavarur të punimeve në fushën e artit. Me ndihmën e internetit, përdoruesi vetë kërkoi informata në maqedonisht që kanë të bëjnë me jetën dhe veprat e disa piktorëve maqedonas të cilat vetë i ka zgjedhur për kërkim. Në shtëpi, kishte për detyrë që të bëjë zgjedhje dhe ti veçojë ato që i duken më interesante dhe më të vyeshme dhe ti vë në prezantimin e përgatitur.

Në takimin e radhës, informatat e zgjedhura i regjistroi në programin për të shkruajtur dhe ftografitë e zgjedhura i kopjonte në dkumenin përkatës. Vetë propozoi se si do dukej dokumenti final të cilin e dërgoi në shkollë dhe e prezantoi para nxënësve dhe arsimtarëve të shkollës.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Tastiera me shkronja cirilike si dhe ekran i përshtatur për punë (ikona të zmadhuara, kursor i zmadhuar, sipërfaqe e rëndomtë e punës).

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përdoruesi mësoi se gjithnjë kur i duhet ndonjë informatë plotësuese lidhur me ndonjë temë të caktuar, mund ti kërkojë ato në internet, nëpër revista, libra etj. Tregoi shumë interes dhe dëshirë gjatë krijimit të revistës si dhe për prezantimin që e bëri para nxënësve të shkollës.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale.

Në këtë aktivitet ishin të kyçur prindërit të cilët u ndihmuan në shtëpi të zgjedhin informata që do ti preantoj te revista si dhe të ushtrojnë leximin dhe përsëritjen e materijaleve që e kanë shkruar. Arsimtari i artit figurativ u informua për aktivitetin që e kanë kryer dhe këtë e pranoi si projekt individual i nxënësit.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky akivitet mund të zbatohet në secilën përmbajtje mësimore, veçanërisht atje ku nxënësi has në vështirësi më të mëdha për ta kuptuar ose për ta përsëritur njësinë mësimore. Keni parasysh që ti përfshini prindërit në realizimin e aktivitetit në shtëpi duke punuar sëbashku në kërkimin dhe gjetjen e informatave, përsëritjen e tyre prgatitjet e duhura për krijimin e prezantimit si dhe të përfshihen nxënësit tjerë dhe bashkërisht të përgatisin prezantime në tema të ndryshme, sëbashku të kërkojnë informata që u duhen etj.

[Aktivitetin e realizoi Magdalena Dimkova-Velevska, defektologe në „Hapni dritaret”.]

3.2

SHEMBUJ PRAKTIK

NGA PËRDORIMI I KOMPJUTERIT DHE TEKNOLOGJISË NDIHMËSE NGA ARSIMTARË DHE PËRFAQËSUES TË SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Titulli i aktivitetit: Uji dhe njerëzit

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja rregullisht e përcjell mësimin, e do punën, ka dëshirë të luaj me shokët dhe shoqet dhe në lojë i respekton rregullat. Reciton në mënyrë të pavarur, dramatizon dhe këndon. I duhet ndihmë e vogël prej arsimtarit ose nxënësi gjatë krahasimit të anës së djathtë ose të majtë, të kryejë veprimtari praktike – prerje, ngjitje, numërim dhe krahasim i numrave gjer më 10, realizim i kontakteve me nxënës tjerë. Rreshtohet në kolonë dhe radhë, luan lojëra arsimore si dhe në kompjuter. Në vështirësi më të mëdha gjatë përcjelljes së mësimit has në: zotërimin e planit dhe programit mësimor, kuptimin e mësimit, të mbajturit mend dhe reprodukimi, njohje të zëri dhe shkronjave, vështirësi në shkrim-këndim, orientimi në hapësirë të fletores, shkruan vetëm me shkronja të mëdha, numërimi i numrave prej 1 deri në 10 para dhe mbrapa, njohje të shifrave të numrave dhe vështirësi në njohjen e shenjave dhe simboleve matematikore, me vështirësi të mëdha minuson deri në 5, me vështirësi i njeh format dhe trupat gjeometrik themelorë.

Qëllimet e aktivitetit:

- Zhvillim, korrigjim i të folurit dhe ushtrim i të shprehurit me gojë;
- Zhvillim dhe orientim i vëmendjes;
- Zhvillim i kujtesës;
- Zhvillim i imazhit pozitiv për vete dhe për mundësitë e tij;
- Zhvillim i pavarësisë dhe disiplinës në realizimin e detyrave të caktuara;
- Zhvillim i ndjenjës së përgjegjësisë;
- Të bëhet e vetëdishme, se me ndryshime të vogla në shprehitë e saj për higjienën, mund të kursej shumë ujë;
- Ta njohë varshmërinë e natyrës së gjallë me atë të vdekur;
- Të bëjë koordinim të lëvizjeve të mausit dhe të kursorit të ekranit;
- Motivimi – punën në kompjuter dhe punën hulumtuese në grup, nxënësen e bën të kënaqur dhe të barabrtë me nxënësit tjerë.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Ky aktivitet pason pas përpunimit të njësisë mësimore “Uji” dhe u realizua për tri orë mësimore. U integruan përmbajtje nga njohuria e natyrës, gjuhë maqedonase dhe matematikë. Për aktivitetet hulumtuese, nxënësit paraprakisht u ndanë në dy grupe me detyrë të zbulojnë mënyra të mundshme për kursimin e ujit në shtëpi dhe jashta shtëpisë. Nxënësja me vështirësi të të mësuarit ishte e kyçur edhe në përgatitjet por edhe në punët hulumtuese me atë që gjatë të regjistrimit dhe

rregullimit të dhënave i ndihmonte një nxënës-asistues. Në diskutimet „Pse uji është i domosdoshëm në jetën e përditshme të njerëzve“ dhe „Uji dhe higjiena personale“ nxënësja dha mendimet e saj lidhur me temat nëpërmjet shembujve nga jeta e përditshme. Zgjedhja e problemit matematikor, për atë se sa herë në ditë i lajnë dhe si i lajnë dhëmbët – në drejtim të kursimit të ujit derisa qëndron procesi i larjes së dhëmbëve, u paraqit para nxënësve. Në këtë mënyrë, nxënësja me vështirësi në të mësuarit, në mënyrë aktive u kyç në orën mësimore. Gjatë realizimit të aktivitetit u përdorën metodat e hulumtimit, deskriptive dhe ajo e dialogut.Puna në orë zhvillohej nëpërmjet formave të ndryshme: individuale, puna në çifte, puna grupore dhe frontale

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.)

Përdorimi i kompjuterëve Intel Classmate dhe i internetit u planifikua dhe u realizua në dy orë mësimore. U përdor përmbajtja mësimore në formë elektronike, prej ueb faqes skoool.mk: „Штедете ја водата дома“ и „Штедете ја водата надвор“. Nxënësja me vështirësi në të mësuarit punon me ndihmën e një bashkënxënësi.

Në orën e maqedonishtes, u përdor softueri arsimor GCompris. Derisa nxënësit tjerë skruanin tekst në „Kaloni në aktivitete zbavitëse“: „Shkruaj tekst“ në temë **Uji dhe njerëzit**, nxënësja me vështirësi në mësim mori për detyrë të zbulojë pse u duhet uji bimëve, nëpërmjet lojës „Kontrolloni markuçin“.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Për Nxënësen me vështirësi në shkrim-këndim, ora e mësimit ishte interesante, sepse në portalin elektronik (Kurseni ujin) **Штедете ја водата дома** përveç tekstit të shkruar ka edhe sqarim me zë me çka i mundësoi më lehtë ti përvetësojë detyrat e dhëna. Ajo punonte e mbështetur prej një bashkënxënësi që i ndihmonte me zvarritje ti vëndojë fjalët në vendet adekuate në tabelë.

Gjatë aktivitetit „Kontrolloni markuçin“ kishtë mundësi, në mënyrë të pavarur për të kuptuar marrëdhëniet në mes të lëvizjes së mausit dhe treguesit në ekran. Gjithashtu kuptoi, se pse uji është i nevojshëm për bimët , ndërsa të shprehurit me gojë zhvillohej me ndihmën e arsimtarit (ushtrime për krijimin e fjalive të plota me radhitje të fjalëve sipas kërkesave gramatikore). Nëpërmjet të lojës e kuptoi varshmërinë e natyrës së gjallë nga ajo e vdekur.

Zbatueshmëria praktike e njohurive: Për arsye se qëllimi primar i kësaj ore ishte që nxënësja ta kuptojë domosdoshmërinë e kursimit të ujit në shtëpi dhe jashta shtëpisë, iu dha detyrë të regjistrojë se si përdoret uji në shtëpi. Ditën e nesërme, erdhi e kënaqur duke treguar se anëtarëve të familjes u ka dhënë disa këshilla dhe sygjerime lidhur me kursimin e ujit.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë kryerjes së aktviteteve, nxënësja me vështirësi në të mësuar kishte ndihmë prej arsimtarit dhe një bashkënxënësi. Gjithashtu, prezente ishte edhe profesoresha e gjuhës angleze, e cila ishte e interesuar për përparimin dhe përfshirjen e saj në të gjithë aktvitetet. Prindërit ishin të përfshirë për kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Në orët e ardhshme nga gjuha maqedonase, prej teknologjisë ndihmëse mund të përfshihet tastiera me shkronja të mëdha për ushtrim të shkronjave të vogla dhe të mëdha të alfabetit cirilik. Mund të vazhdohet me ushtrime për shkrim dhe lexim të fjalëve dhe fjalive të shkurtra me renditje të rregullt. Prej lojërave, mund të përdoret GCompris - „Kliko në shkronjë“.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit: Anita Nikollovska

SHkolla: SHF „Toli Zordumis“, Kumanovë, shkolla periferike fsh. Rezhanovc

Lënda mësimore/njësia mësimore: njohje e mjedisit, gjuhë maqedonase, matematikë.

Titulli i aktivitetit: Përpunim i shkronjave cirilike të shtypit

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja me paralizë celebrale, e cila përveç vështirësive të lëvizjes ka edhe probleme me të pamurit, por ka edhe kujtesë (mbamendje) të shkurtër. Ka spazmë në duar që paraqet hendikep të madh kur shkruan, vizaton, kur ngjyros. Lapsin nuk e mban si duhet dhe ka vështirësi me grafomotorikën. Në mënyrë të pavarur mund t'i rregullojë pajisjet e nevojshme për orën e mësimit, me ndihmën e arsimtarit ose të bashkënxënësit mund ta gjejë faqen e nevojshme në libër ose të fletores, por nuk mundet në mënyrë të pavarur të shkruaj ose përshkruaj, të vizatoj dhe të ngjyros. Në mënyrë të pavarur mund të përgjigjet në pyetje të shkurtra, të mbajë mend strofa dhe ti reprodukojë vetë ose me ndihmën e arsimtarit

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i kësaj ore mësimi është që nxënësi të arrijë ti njohë, ti mbajë mend dhe ti zbatojë shkronat cirilike të shtypit.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në fillim, ora e mësimit fillon me metodën frontale të punës në të cilën gjithë nxënësit kyçen në diskutim lidhur me ilustrimet e shfaqura. Pas kësaj përdoret e ashtuquajtura teknika e rrushit dhe shkruhen fjalët që e përbëjnë shkronjën e re, edhe atë (fillestare) inicijale, medijale dhe finale. Shembull:

Pastaj, secili nxënës e përshkruan rrushin prej tabelës dhe në fletore me vija të gjera dhe të ngushta shkruajnë nga dy rreshta që përmbajnë shkronjën e re (mësim i individualizuar). Tani arsimtari punon individualisht me nxënësin me



nevoja të veçanta arsimore. I tregon për madhësinë dhe dallimin e vijave për të shkruajtur dhe i demonstron se si duhet mbajtur lapsin, si dhe mënyrësn se si duhet shkruar shkronja. Bëhet përsëritje e nocioneve prej fletave të punës dhe demonstrohen mënyrat e të shkruajturit të shkronjave.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Pasiqë nxënësi nuk është në gjendje të shkruaj vetë, përdoret teknologjia ndihmëse, në këtë rast tastiera me taste të mëdha dhe klikime të ndara. Me ndihmën e kompjuterit shumë është lehtësuar puna për të shkruar nxënësit që kanë spazmë në duar. U përdor programi pët të shkruajtur tekst dhe softueri arsimor ToolKID.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësi, me ndihmë të vogël arrinë ti gjejë të gjitha aplikacionet që e përmbajtnë shkronjën që u mësua si dhe të shkruaj me ndihmën e tastierës. Tani më njeh dhe e përdor shkronjën që e mësoi.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Në këtët aktivitet u përfshinë arsimtati si dhe një nxënës-asistent (Kejti Andonovska) të cilët ndihmuan në kryerjen e aktiviteteve të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Nxënësi-asistent kishte rol të rëndësishëm në atë mënyrë që e drejtonte nxënësin në punë, i ndihmonte gjatë aktiviteteve dhe e inkurajonte që pa hezitim ta përdorë kompjuterin duke i demonstruar se si shkruhet.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky shembull i orës mësimore, përveç në orën e gjuhës maqedonase mund të zbatohet edhe në matematikë për përvetësimin e numrave si dhe në gjuhën angleze gjatë përpunimit të shkronjave latine.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profeional:
Mr. Katerina Stojkova – profesoreshë e mësimit klasor
Kejti Andonova – nxënës-asistent
Shkolla: SHF „Vasil Gllavinov“ - Veles
Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë maqedonase: përpunim i shkronjës cirilike të shtypit Kk.

Titulli i aktivitetit: Barazimi i thyesae

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja, gjatë orës së mësimit përdorte karrocën e saj për tu lëvizur nëpër klasë dhe për tu ulur. Ulet në bangën e parë dhe afër saj një nxënëse e shkëlqyeshme, e cila me plot dëshirë i ndihmon kur ka nevojë. Spazma që ia ka kapluar tërë muskulaturën reflektohet edhe në të folur, kështu që nxënësja ka vështirësi të flet si duhet. Gjatë të folurit vie në shpehje edhe dizartrija. Kur kërkohen prej saj përgjigje verbale, pyetjet formulohen në atë mënyrë që kërkojnë përgjigje të shkurtra për shkak të nevojës që të shprehet një kohë më të gjatë. Problemin e zgjodhëm duke i dhënë të drejtë të shprehet me shkrim në pjesën më të madhe të orës së mësimit. Duart i shkaktojnë shumë pengesa për të shkruar dhe lëvizur por dëshira dhe vullneti për sukses i tejkaloi të gjitha vështirësitë. Përdor tastierë të adaptuar me taste të mëdha dhe trakboll-in si zëvendësim mausit. Janë kryer adaptime softuerike të duhura. Është zvogluar ndjeshmëria e mausit, ndërsa tastiera është e përshtatur në atë mënyrë që nëse paraqitet nevoja tasti të mbahet më gjatë i shtypur ose disa herë, ajo të regjistrohet vetëm një herë. Është rregulluar opcioni për taste ngjitëse për të shkruajtur shkronja të mëdha dhe shenjat e pikësimit. Spazma bën që koka të qëndrojë një kohë më të gjatë në pozitë të njëjtë, prandaj ikonat janë të zmadhuara në sipërfaqen e punës. Gjithashtu është rritur edhe fondi i dritareve që përmban vegla për punë në kompjuter. Vet e kyç kompjterin deh hap dokumentin përkatës. Me vëmendje të veçantë i përcjell aktivitetet në orë dhe i përvetëson qëlimet e parapara sipas programit mësimor, duke u lëvizur prej nivelit të mbamendjes sipas Taksonomisë së Blumit.

Qëllimi i aktivitetit:

- të përcaktojë se a janë të dy thyesat e barabarta.

Qëllimi i diferencuar (PIA):

- ta mbajë mend përcaktimin e procedurës kur dy thyesa janë të barabarta;
- të përforcohet pavarësimi gjatë zgjidhjes se detyrave;
- të zhvillohet vëmendja dhe qëndrueshmëria e saj.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Arsimtari e paraqet qëllimin e orës. Bën thirrje që nxënësit ta përcjellin arsimtarin çka bën që mandej nxënësit ta bëjnë atë. Merr një mollë dhe e pret me thikë në dy pjesë, mandej secilën pjesë edhe dy herë. Merr dy pjesë më të vogla të mollës dhe parashtron pyetje: “Si do ta kishit paraqitur këtë pjesë të mollës me thyesa?”. Arsimtari e shkruan përgjigjen në tabelë. Me njërën dorë e afron pjesën e mollës që i përgjigjet ¼, ndërsa me dorën tjetër dy pjesët e mollës që i përgjigjet 2/4, dhe bën pyetje: “A ka sasi

të njëjtë të mollës në të dy duart?" dhe shkruan shenjën e barazimit ndërmjet thyesave dhe thotë se në të dy duart ka sasi të njëjtë të mollëve. Shkruan shembull në tabelë (1/3 dhe 2/6). E shkurton thyesën 2/6 me 2, që të shohin nxënësit se thyesat janë të barabarta. Thekson se thyesat mund të krahasohen vetëm kur do të vijnë në emërues të pëbashkët. E dikton definicionin për barazimin e thyesave. Jep shembuj të përafërt për nxënësit. Jep shembuj nga jeta e përditshme me krahasim, kur një fëmijë blen 2/8 byrek, ndërsa tjetri ¼ dhe bën pyetje se cili fëmijë ka blerë pjesë më të madhe. Nëpërmjet pyetjeve të nxënësve i përsërit nocionet e reja dhe u jep detyra shtëpie.

Gjatë orës mësimore, nxënësi me nevoja të veçanta arsimore e hap programin kompjuterik që i përgjigjet orës mësimore nga matematika (Math). Në fletëzën mësimore janë të dhëna disa përgjigje prej të ciave vetëm një është e saktë. Arsimtari i bën pyetje këtij nxënësi duke ia treguar fletëzën mësimore. Tregon në përgjigjet e mundshme një nga një me pyetjen "A është e saktë?" derisa nxënësi ta gjejë përgjigjen e saktë. Arsimtari përcjell nëse nxënësi përshkruan prej tabelës në kompjuter dhe me anë të bisedës dhe vëzhgimit bindet se a i ka kuptuar detyrat e dhëna. Me anë të USB ia transferon detyrat e shtëpisë.

Metodat: me shkrim, bisedë, vizatim, diskutim, metoda e demonstrimit, metoda bashkëbiseduese, metoda problemore, metoda e punës praktike, metoda e vëzhgimit. *Tehniki: punon në* çifte dhe shkëmben, pushim për sqarime, pritje, fantazmë e orientuar, tabela e parashikimeve, stuhi idesh, harta mendore. *Format:* individual, frontale, në çifte dhe e individualizuar. *Mjete*: libri, tabaela, shkumësi, mollë, thikë. *Mjet diferencues (PIA):* kompjuteri (Math), fletë mësimore me përgjigje të mundshme të thyesave.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Tastierë e adaptuar me taste të mëdha, trakboll, Math.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Për arsye se shkruan më ngadalë, parapamë që nxënësja ta mbajë mend procedurën për kontrollimin e barazisë së thyesave (të vijë deri te emëruesi i përbashkët). Nxënësja na befasoi dhe na gëzoi kur e zbatoi rregullën dhe filloi ta zgjedhë detyrën sipas rregullave. Kur arritëm në zbatueshmërinë në jetën e përditshme, nuk arriti ta zgjedhë detyrën (detyrë tekstuale).

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Rol dhe pjesëmarrje aktive kishte nxënësja që ulej në bangën e njëjtë. Nëna, në shtëpi duhet të kontrollojë a e ka kryer detyrën e shtëpisë. Defektologu i shkollës, ndihmoi gjatë planifikimit të orës mësimore.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Me vullnet të mirë, me punë ekipore dhe me pak kreativitet, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, në mënyrë të suksesshme mund të animohen në aktivitetet mësimore. Që të arrihet kjo, është i nevojshëm vëzhgimi aktiv i interesave dhe pjesëmarrja aktive e nxënësit si në orë mësimore gjithashtu edhe gjatë pushimit ose të shoqërimit me nxënësit tjerë në shkollë dhe jashta saj. Njëherë, kur të gjendet mënyra që është adekuate për një nxënës, është shumë lehtë të planifikohen aktivitetet sepse vazhdimisht lindin ide të reja.

Emri i arsimtarit: Biljana Poovska Filipova, defektologe: Elizabeta Sekulloska

Shkolla: SHF "Goce Dellçev" - Prilep

Lënda mësimore/ njësia mësimore: matematikë: Barazimi i thyesave

Titulli i aktivitetit: Njohja e shkronjave të alfabetit të gjuhës maqedonase

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Gjatë realizimit të njësive mësimore të paraparë me programin mësimor, te një nxënës i kl.II është vërejtur se ka vështirësi të njohjes së shkronjave cirilike të vogla dhe të mëdha të shtypit të alfabetit të gjuhës maqedonase. Nxënësi, assesi nuk mundej ti njohë dhe ti përshkruaj shkronjat.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i aktivitetit është që nxënësi të mësohet ti njohë shkronjat e vogla dhe të mëdha të shtypit prej alfabetit të gjuhës maqedonase dhe mënyrën se si shkruhen ato.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Me përdorimin e tastierës me taste të mëdha, nxënësi e theu barrierën për njohjen e shkronjave, pastaj filloi ti shkruaj me anë të tastierës. Gjatë aktiviteteve nëpërmjet lojës "në shkronjën, në shkronjën...", filloi të formojë fjalë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë realizimit të këtij aktiviteti e përdorëm tastierën me taste të mëdha dhe programin Microsoft Office Word.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përdorimi i teknologjisë në realizimin e përmbajtjeve, këtij nxënësi i ndihmoi të jetë i vetëdijshëm dhe të punojë në problemin e tij duke u fokusuar në përparësitë në vend të dobësive. Në fund, rezultatet ishin të dukshme: tani, nxënësi me më pak i njeh dhe i lexon fjalët.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë reaizimit të aktiviteteve të parapara me përdorimin e tastierës me taste të mëdha, u përfshinë edhe nxënës tjerë të cilët ndihmuan.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Përdorimi i teknologjisë ndihmëse është e zbatueshme në të gjithë lëndët mësimore, jo vetëm për atë se anashkalon disa mangësi, por ajo sjell përparësi të mëdha te fëmijët të cilët kanë nevojë për këto. Përdorimi i tastierës me taste të mëdha mund të zbatohet edhe në matematikë për njohjen dhe shkruarjen e numrave.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Arsimtar klasor : Dobri Jovevski

Shkolla: SHF "Ilinden" – Kriva Pallankë

Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë maqedonase

Titulli i aktivitetit: Fjalët rënëse

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi ngec intelektualisht dhe nuk mund të arrijë objektivat e përcaktuara me programin dhe planin mësimor për klasën përkatëse.

Qëllimi i aktivitetit:

- nxënësi duhej të aftësohet të shkruaj shronja të shtypit, të aftësohet për të lexuar fjalë, të shkruaj fjalë dhe të mundet ti përdorë shkronjat nga tastiera me taste të mëdha;
- përmes vizualizimit të motivohet ti mësojë përmendsh shkronjat cirilike të shtypit të gjuhës maqedonase;
- inkurajim dhe ngritjen e nivelit të zhvillimit të disa aftësive dhe shkathtësive te nxënësi;
- mësim nëpërmjet lojës.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Lidhur me temën „Leximi dhe shkrimi fillestar“, në fillim, me nxënësin u përdorën metodat dhe format standarde të punës me individualitet të theksuar në punë. Vërejtëm se nxënësi nuk e preferon lapsin e rëndomtë për të shkruar dhe ka dëshirë të shkruaj me flomaster me ngjyrë intenzive. Lejuam të shkruaj në fletore me flomasterme ngjyrë që të arrijmë deri te qëllimi. Kishte progres në punë. Nxënësi, për çdo ditë kërkonte të shkruaj me flomaster me ngjyrë a me këtë edhe koncentrimi i tij rritej dhe ishte më i madh.

Ti inkurajuar prej kësa,j lindi ideja ta përdorim tastierën me taste të mëdha prej pajisjeve ndihmëse që i fituam nga “Hapni dritaret” që ta rrisim motivimin në nivel më të lart.

- Lojërat arsimore prej GCompris – softuerit edukativ i punuam me nxënësit tjerë duke i përdorur laptopët e vegjël të shkollës. Të njëjtën e bëmë ehe me këtë nxënës, por me tastierë ndryshe (me taste të mëdha dhe ngjyranqë i donte shumë).
- Përdorimi i kohëpaskohshëm i tastierës me ngjyra, flomaterët me ngjyra intezive, bëb që nxënësi ta mësojë alfabetin e gjuhës maqedonase (alfabetin cirilik), dhe tani din edhe një numër të mirë të shkronjave të shkrimit.
- Nxënësi, tanimë do të punojë dh shkruaj me laps të rëndomtë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Nxënësi ka motorikë të mirë dhe përdor maus standard, por e përdorte tastierën me taste të mëdha me ngjyra e cila në masë të madhe e motivonte atë që ti mësojë shkronjat e shtypit të alfabetit të gjuhës maqeonase.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Qëllimet u arritën – nxënësi u aftësua të shkruaj dhe lexojë shkronja të shtypit dhe fjalë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Shokët e tij të paraleles, me plot dëshirë pranojnë ti ndihmojnë bashkënxënësit të tyre. Takime individuale me bashkëpunëtorët profesional – pedagog, psikolog dhe ndihmë e rastit nga defektologu (shkolla jonë tani për tani nuk ka të punësuar defektolog).

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktiviteti mund të zbatohet edhe në lëndët tjera (p.sh. shkruarja e numrave – matematikë, në tastierë me taste të mëdha).

Emri dhe mbiemri i atsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Evdokija Petrushevska- arsimtar

Shkolla: SHF "Johan Hajnrih Pestaloci" - Shkup

Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë maqedonase: shkrimi dhe leximi fillestar

Titulli i aktivitetit: Situata problematike të rëndomta – Hijet

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi, pavarësisht i realizon dhe i zgjidh detyrat më të rëndomta të dhëna prej arsimtarit. Kur has në ndënjë problem i ndihmojnë nxënësit tjerë dhe arsimtari me qëllim që të mos mbetet prapa nxënësve tjerë. Por,kur duhet të kryejë detyra më të ndërlikuara dhe më të rënda, atëherë ai nuk mundet dhe reziston gjatë punës. Përndryshme, sipas mundësive është i përfshirë në të gjitha aktivitetet dhe qëllimet sipas programës për nxënës me nevoja të veçanta arsimore , realizohen.

Qëllimi i aktivitetit:

- Të aftësohet për zgjidhjen e situatave problematike të rëndomta nga jeta e përditshme;
- Të zhvillohet motorika e dorës;
- Të mundet që prej më shumë hijesh ta gjejë hijen konkrete të figurës së dhënë;
- Nxënësi, për realizimin e orës mësimore është i motivuar me përdorimin e kompjuterit.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Në fillim të orës, nxënësit i dërgoj në oborrin e shkollës dhe i radhiti në rend të drejtë.Secili nxënës e sheh hijen para tij dhe vijmë në përfundim se secila hije ka kokën, krahë dhe këmbë. Pastaj, nxënësit i shohin hijet e drujve, të gurëve, të topit dhe gjithçka që gjendet në oborrin e shkollës. Nxënësi, sëbashku me shokun e tij që është si mentor, shkon deri te objekti apo sendi, e sheh hijen dhe e përshkruan se çfarë ka parë.

Kthehemi në klasë. Nxënësit tjerë kur shkruajnë në fletore sende të ndryshme me hije, nxënësit i jepet kompjuter dhe hyn në softuerin arsimor ToolKID në aplikacionin **Hijet.** Me anë të mausit duhet ti qëllojë hijet prej sendeve të dhëna. Nivelin e parë e kalon vet, të dytin deri diku dhe pastaj kyçet nxënësi-mentor i cili ndihmon ta luaj lojën, dmth. Ti qëllojë edhe hijet më të imta.

Në fund të orës e zgjedhin detyrën në librin e matematikës. Të gjithë nxënësit do të duhet ti numërojnë sendet dhe ti lidhin me hijen përkatëse, ndëras nxënësi do të duhet ta lidh sendein me hijen përkatëse.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Kompjuteri u përdor në pjesën kryesore të orës mësimore me softuerin arsimore ToolKID me aplikacionin **Hijet.**

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Me realizimin e kësaj ore, përfitimet për nxënësin janë të mëdha. Ai, mësoi q nëpërmjet kmpjuterit ta njohë hijen

në sendin e dhënë, p.sh. figura të ndryshme. Në këtë mënyrë u aritën qëllimet që ishinn të planifikuara më parë sipas programës.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. U përfshi edhe një nxënës tjetër që e luajti rolin e mentorit, që i dihmonte nxënësit ti përvetësojë nivelet më të larta të lojës **Hijet.**

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të zbatohet edhe te lënda njohje e mjedisit në klasën e tretë dhe lënda natyra në klasën e katër, kur përpunohet njësia mësimore Hijet.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Gordana Atanasova
Shkolla: SHF "Shën Kliment Ohridski" - Manastir
Lënda mësimore/ njësia mësimore: matematikë: Hijet

Titulli i aktivitetit: Krahasimi i numrave

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja me paralizë cerbrale e cila përveç vështirësive të lëvizjes, ka problem edhe me të pamurit dhe mbamendja e shkurtër. Ka spazma në duar që i shkakton problem në të shkruar, në vizatim dhe ngjyrosje. Lapsin nuk e mban si duhet dhe ka vështirësi me grafomotorikën. Mundet vetë t'i rregullojë pajisjet e duhura për orën e mësimit, me ndihmën e arsimtarit apo nxënësit-mentor e gjen faqen e duhur në fletore apo në libër, por nuk mundet në mënyrë të pavarur të përshkruaj, të shkruaj, të vizaton ose të ngjyros. Pavarësisht mund të përgjigjet në pyetje të shkurtra, të mbajë mend strofa dhe ti reprodukojë vet ose me ndihmën e arsimtarit. Mundet të zgjedh detyra të rëndomta.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i kësaj ore është nxënësi të mundet ti njohë, ti mësojë përmendsh dhe ti zbatojë numrat e mësuar dhe operacionet themelore matematikore.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Ora e mësimit fillon me metodën frontale të punës ku e gjithë klasa me ndihmën e ilustrimeve dhe të materijalit didaktik, mëson për krahasimin e numrave. Shembull:







Shkruhen detyra në tabelë, të cilat duhet ti zgjedhin nxënësit në mënyrë frontale. **Shembull:**

Vëndo shenjën e duhur:

2 ☐ 5, 7 ☐ 7, 10 ☐ 1, 6 ☐ 8, 9 ☐ 4

Nxënësit i përshkruajnë detyrat prej tabelës dhe në mënyrë të pavarur i zgjedhin ato në libër. Arsimtari punon individualisht me nxënësin nevoja të veçanta arsimore. Njëherë përsëriten detyrat prej aplikacioneve, pastaj nxënësi vetë me ndihmën e materijaleve didaktike (katrorë, ngjyra...) zgjidh detyra me krahasimin e numrave.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Pasiqë nxënësi nuk është në gjednje vetë të shkruaj, përdoret teknologjia ndihmëse edhe atë me tastierë me taste të mëdha dhe me klikime të ndara. Me ndihmën e kompjuterit, shumë është lehtësuar të shprehurit me shkrim te nxënësit me spama në duar. Është përdorur softueri arsimor ToolKID me lojëra me lojëra për krahasimin e numrave.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësi, vetë arrin që ti zgjidhë detyrat me krahasimin e numrave nga dhjetëshja e parë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Në këtë aktivitet u kyçën arsimtari klasor por edhe nxënësi-mentor (Kejti Andonovska) të cilët ndihmuan në realizimin e aktiviteteve të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Nxënësi-mentor, kishte rol të madh në aspekt të orientimit të nxënësit, i ndihmonte gjatë aktiviteteve dhe e inkurajonte që pa kurrfarë hezitimi ta përdorë kompjuterin.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Kjo orë mësimore, përveç në matematikë mund të zbatohet në gjuhën angleze për përvetësimin e numrave dhe të operacioneve matematikore në gjuhë të huaj.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
mr. Katerina Stojkova – profesor i arsimit klasor,
Kejti Andonova – nxënës-mentor

Shkolla: SHF "Vasil Gllavinov" - Veles

Lënda mësimore/ njësia mësimore: matematikë:
Krahasimi i numrave nga dhjetëshja e parë

Titulli i aktivitetit: Aplikimi i programit ToolKID : Njerëz - Vizatimi i frutave dhe perimeve

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi, pjesën më të madhe të aktivitetit e kryen në mënyrë të pavarur. Ndihmë e arsimtarit i duhet kur shkruan në fketore ose kur vizaton në letër të bllokut sepse ka probleme me motorikën. Në orën e mësimit merr pjesë aktive kur bëhet fjalë për shprehje verbale dhe, edhepse me nxitje dhe inkurajim i arrin qëllimet.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimin që duhet ta arrijë nxënësi është që te ai të zhvillohen aftësitë grafomotorike dhe koordinimi i syrit me dorën.

Qëllimi i planit individual arsimor është, nxënësi të inkurajohet në mënyrë kreative të shprehet me anë të ngjyrave.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Nëpërmjet pyetjeve për frutat, nxënësit orientohen për aktivitetet e mëtutjeshme. Parashtrohen pyetje për frutat që gjinden te ne, përshkruhet secili produkt u frutave, forma, ngjyra dhe madhësia. Nxënësit përgjigjen në pyetjet e parashtruara.

Format e punës: frontale, individuale, mësim i individualizuar.

Metodat e punës: bashkëbiseduese, diskutim, përshkrim, demonstrim dhe punë praktike.

Nxënësi merr pjesë në dhënien e përgjigjeve gjatë përshkrimit të produktit të frutave. Me pyetje nxitëse vihet deri te përgjigjet. Nxënësve u jepen udhëzime për transferimin e përvojave dhe përshtypjet ti vënë në fletë të bllokut duke përdorur ngjyrat e ujit. U shpjegohet mënyra e punës sepse janë në moshë gjashtëvjeçare. Secili nxënës në mënyrë të pavarur vizaton produkte frutash.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Për arsye se nxënësi ka vështirësi me motorikën dhe me orientimin e fletës, punon në kompjuter duke përdorur softuerin ToolKID, dhe programin **Njerëz**.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitimet nga ky aktivitet janë: nxënësi, duke punuar me këtët program, përkatësisht duke aplikuar kompjuterin për realizimin e aktivitetit e përmirëson koordinimin e lëvizjes së dorës dhe të gishtërinjve nëpërmjet ngjyrosjes. Konkretisht, nxënësi ka orientim në hapësirë, sepse ai është i shënuar dhe dihet se deri ku mund të ngjyroset. Personazhet – perimet janë dhënë si produkt final, ka zgjedhje të ngjyrave të cilat shumë e lehtësojnë punën. Me këtë, nxënësi, aktivitetin e kryen si nxënësit tjerë, a kjo është sukses edhe për atë dhe paraqet kënaqësi të veçantë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë realizimit të aktivitetit është i përfshirë edhe arsimtari. Në fakt, ai i sqaron se ku duhet të klikojë për tu paraqitur perimet, prej ku dhe ku të merr ngjyrën për të ngjyrosur.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktiviteti është shembull praktik dhe është i zbatueshëm jo vetëm në lëndën e artit figurativ por edhe në lëndët tjera – njohja e mjedisit në ndënjë segment të orës apo si përsëritje, në gjuhën maqedonase për përshkrim, për ta qëlluar frutin e duhur gjatë lojës "Në shkronja", matematikë për ngjyrosje.

Emri dhe mbimri i arsimtarit/ anëtar i shërbimtit profsional:
Arsimtari klasor – Snezhana Stojanova, pedagoge e diplomuar

Shkolla: SHF "Shën Kliment Ohridski" - Manastir

Lënda mësimore/ njësia mësimore: arsim figurativ:
Vizatim i frutave dhe perimeve

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi mund të shkojë vet në shkollë, për ti përmbushur nevojat e tij personale, siç janë: shkuarja në tualet, përmbledhjen e mjeteve mësimore, të ushqyerit e pavarur. Ka neojë për ndihmë nga arsimtari/ bashkënxënësi gjatë përgatitjes për orën e arsimit fizik dhe shëndetësor (veshmbathje, lidhja e patikave), gjatë realizimit të njësive mësimore për zhvillimin e trupit, (ushrime për përqëndrim, të ekuilibrit dhe aktivitetete tjera sportive). Vështirësi më e madhe paraqitet kur duhet të shkruar për çka has në mirëkuptim te nxënësit tjerë se i duhet më tepër kohë për të arritur objektivat e orës së mësimit. Gjithashtu, ka nevojë të mungojë prej orëve të mësimit dhe prej shkollës për arsye të vizitës së entit shëndetësor (për arsye të ushtrimeve, rehabilitimit etj.), dhe për këtë arsye merr ndihmë prej shokëve në atë mënyrë që i tregojnë se çka është punuar në shkollë, çka kanë mësuar, çfarë detyrash kanë dhe njëkohësisht ndihmojnë në kryerjen e tyre.

Qëllimi i aktivitetit. Të shkruaj drejt, pastër dhe bukur fjalë dhe fjali sipas diktimit të dhënë për zhvillimin e dejtë të motorikës dhe të kujtesës. Përdorimi i drejtë dhe i plotë i i tingujve gjatë t folurit dhe i shkronjave në të shkruajtur.

Përdorimi i normave elementare drejtshkrimore gramatikore gjatë shkrim-leximit.

Zhvillimi i komunikimit social dhe ekonomik dhe adaptim në paralele të kombinuar me dy klasë.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Nxënësi, për arsye të motorikës së ngadalsuar merr detyrë të posaçme që duhet ta ralizojë me ndihmën e fletëzës së punës, kështu që aktiviteti i shkruarjes së diktimit kalon në përshkrim prej alfabetit cirilik në atë latn, me qëllim që mos të ketë vështirësi gjatë realizimit të objektivit të përcaktuar për këtë orë mësimore në paralele të kombinuar me dy klasa. Gjatë realizimit të orës përdoret tekst metoda, metoda individuale dhe ajo e demonstrimit.

Nxënësi, punon pavarësisht gjatë orës së mësimit për çka pa asnjë problem i pranon udhëzimet e dhëna nga arsimtari, i cili gjatë gjithë procesit ofron ndihmë individuale në është e nevojshme.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Kompjuteri në klasën tonë përdoret për çdo ditë, për çka, për të arritur qëllimin konkret nga aktiviteti i dhënë për të shkruar diktatin është përdorur aplikacioni Writer, ndërsa për të arritur qëllimet nga plani dhe programi mësimor, nxënësi e përdor softuerin arsimor ToolKID, GCompris, Paketa e gjelbër Junior.

Nga teknologjia ndihmëse është përdorur tastiera me taste të mëdha, trakbolli dhe klikime të ndara. Leva (xhojstiku) si vegël ndihmëse përdoret kohë pas kohe, më shpesh gjatë aktivieteve zbavitëse me qëllim të ushtrimit të motorikës. Në internet janë përdorur linqe me lojëra, me ndihmën e të cilave mund të zhvillohet motorika, kujtesa dhe përmirësimi i të folurit. Në këto linqe ka në dispozicion edhe e-libra.

http://www.e-ucebnici.mk/

http://www.primarygames.com/puzzles/match_games.php

http://www.abcya.com/connect_the_dots_10.htm

http://www.abcya.com/memory_2.htm

http://www.kidsastronomy.com/fun/shape_match.htm

http://www.vinica.org/kidsplanet/placenumbers.swf

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Me arritjen e teknologjisë ndihmëse, në klasën tonë te nxënësi u lehtësua puna gjatë realizimit të njësive mësimore. Ai ishte në gjendje të jetë i pavarur në realizimin e detyrave të caktuara dhe të përfshihet në aktivitetin real të planifikuar për këtë orë mësimi, dhe me ndihmën e teknologjisë tani mund të shkruaj diktatin njësoj si edhe nxënësit tjerë, vetëm se kjo do të punohet me ndihmën e kompjuterit.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë realizimit të këtij aktiviteti, nxënësi merr ndihmë prej arsimtarit dhe prej nxënësve tjerë, të cilët kanë shumë mirëkuptim në klasë, por për realizimin e aktiviteteve tjera ka ndihmë prej prindërve lidhur me përdorimin e teknologjisë ndihmëse që i ka në shtëpi, të cilat ia ka dhënë shkolla në përdorim, duke iu falënderuar organizatës „Hapni dritaret“.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të aplikohet edhe gjatë realizimit të njësive mësimore në lëndët tjera ku duhet të shkruhet teskt, të rregullojë elemente me çka e përmirëson memorien gjatë zgjidhjes se detyrave matematikore, gjatë të e-mësuarit.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
arsimtar klasor : Zhivka Stoilkovska dhe Natasha Mlladenovska

Shkolla: SHF “Ilinden” – Kriva Pallankë

Lënda mësimore/ njësia mësimore:
gjuhë maqedonase: Shkruarja e diktimit

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënëse me paralizë cerebrale, e cila përveç vështirësive në lëvizje, ka probleme me të pamurit dhe mbamendje të shkurtër. Ka spazma në duar që paraqet hendikep në të shkruar, vizatim dhe ngjyrosje. Nuk e mban lapsin si duhe si dhe me vështirësi në grafomotorikë. Është në gjendje ti rregullojë përgatitjet e duhura për orën e mësimit, me ndihmën e arsimtarit ose të nxënësit-mentor ta gjejë faqen e duhur në fletore ose në libër, por nuk mundet vet të përshkruaj ose të shkruaj, të vizatojë dhe të ngjyros. Nxënësja në mënyrë të pavarur mund të përgjigjet në pyetje të shkurtra, të mësojë përmendsh strofa dhe ti reprodukojë apo me ndihmën e arsimtarit. Mundet të zgjidh detyra të rëndomta.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i kësaj ore është që nxënësi ti njohë, të mbajë mend dhe ti aplikojë ngjyrat dhe format primare.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Ora e mësimit fillon me metodën frontale kur e gjithë klasa luan me tullumbaqe. Arsimtari parashtron pyetje: Si janë tullumbaqet sipas ngjyrës?

Nxënësit i numërojnë ngjyrat e tullumbaqeve : e kuqe, e gjelbër, e kaltër, ngjyrë vjollcë...

Pastaj arsimtari i veçon tullumbaqet me ngjyra primare : e kuqe, e verdhë, e kaltër dhe nxënësve u thotë të mbajnë mend se e kuqja, e kaltërta dhe e verdha, janë **NGJYRA PRIMARE**.



Arsimtari u tregon nxënësve se do të punojnë me ngjyrat primare, por se edhe me përzierjen e tyre fitohen ngjyra tjera, por edhe me përzierjen e tyre fitohen të gjitha ngjyrat. Nxënësit janë të informuar se e kuqja, e verdha dhe e kaltërta nuk fitohen me përzierjen e asnjë prej këtyre ngjyrave, prandaj edhe quhen ngjyra primare.

Pas kësaj nxënësit njihen me aktivitetet në klasë: vizatim dhe ngjyrosje në temë: Buqet prej tullumbaqeve me ngjyra primare. Për ngjyrosjen e

vizatimeve, nxënësit do të përdorin ngjyra të ujit. Në fund të orës së mësimit, me vizatimet më të mira do të organizohet ekspozitë. Çdo nxënës fillon të punojë individualisht në vizatimin e tij.

Arsimtari punon individualisht me nxënësin me nevoja të veçanta arsimore. Sëpari përsëriten ngjyrat e tullumbaqeve, dhe pastaj nxënësi vet i veçon tullumbaqet me ngjyra primare.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Pasiqë nxënësi nuk është në gjendje vet të vizatojë dhe të ngjyros, përdoret teknologjia ndihmëse edhe atë me tastierë me taste të mëdha dhe me klikime të ndara. Me ndihmën e kompjuterit shumë është lehtësuar të shprehurit me shkrim te nxënësit me spazmë në duar. Është përdorur softueri arsimor ToolKID me lojërat e tullumbaqeve si dhe Gnu Paint për vizatim dhe ngjyrosje.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësi në mënyrë të pavarur arrin të vizatojë në kompjuter buqet prej tullumbaqeve dhe ti ngjyros me ngjyrat primare.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Në këtë aktivitet u kyç arsimtari klasor si dhe nxënësi-mentor (Kejti Andonovska) të cilët ndihmuan në realizimin e aktiviteteve të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi-mentor kishte rol të madh në atë që e drejtonte nxënësin në unë, i ndihmonte gjatë aktiviteteve (ku të klikojë për ndonjë formë, ngjyrë...) dhe e inkurajonte që pa kurrfarë frike ta përdor kompjuterin.

Zbatueshmëria eaktivitetit. Ky shembull për orën e mësimit, përveç në arsimin figurativ, mund të aplikohet në gjuhën angleze për përvetësimin e ngjyrave dhe formave në gjuhë të huaj por edhe në matematikë gjatë përpunimit të formave dhe trupave gjeometrikë.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional: mr. Katerina Stojkova – profesoreshë e grupit klasor, Kejti Andonovska – nxënës-mentor

Shkolla: SHF "Vasil Gllavinov" - Veles

Lënda mësimore/ njësia mësimore: arsim figurativ: Ngjyrat primare

Titulli i aktivitetit: Zgjerimi i vokabularit

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënës i klasës së tetë me vështirësi në përetësimin e përmbajtjeve mësimore. Te ky nxënës vërehet diskgrafi në dorëshkrim (dorëshkrimi është shumë i paqartë) dhe nuk të folur tl zhvilluar mirë.

Qëllimi i aktivitetit:

- njohje e fjalëve të reja (school, hospital, airport, café...);
- inkurajim i të folurit;
- mbajtja e vëmendjes;
- motivimi.

Përshkrim i aktivitetit. Përsëritje e fjalëve të reja pas arsimtarit, thënie e fjalëve në mënyrë të pavarur, futje e shkronjave të lëshuara, lidhje e fjalëve me fotografi. Me nxënësin punohet në mënyrë individuale a sipas nevojës përfshihet edhe nxënës tjetër. Gjatë orës përdoren edhe fletëza mësimore. Bashkëpunimi me këtë nxënës është në nivel të duhur duke vendosur kontakt të mirë me nxënësin.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë orës së mësimit u përdorën pajisjet ndihmëse (tastiera me taste të mëdha), ndërsa prej programeve u përdoron Gcompris, ToolKID dhe ueb faqja e internetit

www.egglishexercises.org/makeagame/viewgame.asp?id-6967

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitimet nga kjo orë mësimore ishin të mëdha sepse nxënësi e arriti qëllimin që ishte planifikuar pët këtë, në mënyrë të pavarur e kreu detyrën, u pasurua fjalori i nxënësit me fjalë të reja, ndërsa përfitim më i madh ishte ajo se nxënësi arriti ta përqëndrojë vëmendjen dhe të inkurajohet për të menduar për detyrën e dhënë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë orës së mësimit kohë pas kohe përfshihej nxënësi që ulej me të për ti ndihmuar, përkatësisht nxënësi kishte nevojë për ndihmë rreth punës në internet.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të aplikohet edhe në lëndën e gjuhës maqedonase dhe të arsimit figirativ, në formë të përsëritjes dhe të vizatimit.

Emri i arsimtarit: Biljana Stoillkova
Shkolla: SHF "Sllavço Stojmenski" - Vinicë
Lënda mësimore/ njësia nësimore:
gjuhë angleze: Zgjerimi i vokabularit

Titulli i aktivitetit: Hartim me shkrim nga gjuha maqedonase

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja lëviz me ndihmën e karrocës invalidore, pozita e trupit të saj nuk i lejon ta mbaj fletoren si duhet dhe të shkruaj ose të krijojë teste në orët e mësimit si dhe ta mbajë dhe të ketë kujdes për librin. Mund të shprehet në mënyrë të pavarur, gojarisht ti transmetojë njohuritë e saj dhe të merr pjesë në diskutime gjatë orëve mësimore. Kjo situatë ia vështirëson punën, nuk mund ta përcjellë njësinë mësimore krejtësisht dhe nuk mund të merr pjesë në aktivitete që kërkojnë të shkruash në fletë ose në fletore.

Qëllimi i aktivitetit. Aplikimi i teknologjisë ndihmëse (trakboll) dhe tastierë virtuele gjatë krijimit të hartimit me shkrim.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Arsimtarja e gjuhës maqedonase cakton hartim me shkrim me çka tema për të cilën do të shkruhet, nxënësja e merr në formë elektronike. Nxënësja përdor pajisje ndihmëse trakboll dhe tastierë virtuele për shkruarjen e temës së hartimit me shkrim. Pas kryerje së aktiviteit, arsimtarja e mer poashtu në formë elektronike hartimin e punuar për ta korrigjuar.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Nxënësja përdor trakboll dhe tastierë virtuele.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitime te nxënësja regjisrohen në saje të kënaqësisë nga pozita e barabarsisë me nxënësit tjerë, motivimi më i madh te nxënësja për arsye të mundësisë që me kohë ta merr dhe ta punojë hartimin me shkrim, si dhe përfitim në saje të vlerësimit transparent dhe të drejtë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Përfshirje e bashkëpunëtorit profesional në saje të punës kështilldhënëse me arsimtaren e gjuhës maqedonase.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky lloj aktiviteti në lidhje me nxënësen, e praktikuan një numër i madh arsimtarësh në shkollë lidhur me zgjidhjen e testeve, krijimit të fletëzave mësimore, ushtrime me shkrim dhe detyra si dhe përdorimin e e-librave.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
arsimtar - Katerina Ilieva, psikologe – Anita Kitanoviq

Shkolla: SHF "Josip Broz Tito" - Vallandovë

Lënda mësimore/ njësia mësimore:
gjuhë maqedonase: Hartim me shkrim

Titulli i aktivitetit: Transmetimi i fakteve dhe i mendimeve (lexim, shkrim dhe të folur) me zbatimin e TIK-ut

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi kupton një fond të kufizuar fjalësh me shumë gabime, me vështirësi pranon konstrukte gramatikore duke bërë një numër të madh gabimesh të cilat e pengojnë tëkuptuarit, njeh numër të vogël fjalësh dhe fjalish në kontekst të dhënë dhe pjesërisht shkruan dhe përkthen tekste të shkurtra me ndihmën e arsimtarit. Has në vështirësi gjatë përshkrimit në vokabularin e ri dhe në gramatikë prej tabelës.

Qëllimi i aktivitetit. Nxënësi të mundet të flet për fakte dhe të shkruaj disa fakte për klasën e tij. Nxënësi me vështirësi kupton se ç'është fakt dhe çka është mendim, mban mend numër të vogël faktesh të cilët me vështirësi i reprodukon dhe me ndihmën e arsimtarit, me ndihmën e bashkënxënësve të grupit dhe të dhënave prej internetit shkruan dy gjer më tre fakte, nuk shpreh aktivitet në orën e mësimit, vështirë motivohet dhe merr pjesë gjatë prezantimit të fakteve për klasën e tij nga grupi i tij, duke reprodukuar një fakt edhe ai me ndihmën e tyre.

Përshkrim i shurtër i aktivitetit. Shkruhen më shumë fakte dhe mendime në tabelë, me qëllim nxënësit të aftësohen për ti dalluar. Pas kësaj duhet të gjejnë fakt në tekstin që për ta është ineteresant, pastaj e lexojnë dhe japin mendimet e tyre. Plotësohet ushtrimi 3/b dhe në grupe të shkruajnë fakte tjera duke shfrytëzuar informata prej internetit dhe ti lexojnë. Pastaj në grupe shkruajnë fakte për klasën e tyre dhe i prezentojnë. Aplikohet metoda komunikative, puna në grupe dhe ajo individuale. Arsimtari i ndihmon nxënësit për të gjetur fakte në tekst. Bashkënxënësit bashkëpunojnë me nxënësin gjatë shkruarjes së fakteve prej internetit duke i ndihmuar në gjetjen e fakteve dhe hartimin e fakteve për klasën.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë punës me kompjuter, nxënësi përdor tastierë të adaptuar me taste të mëdha.

Linku i përdorur - www.animalfacts.com

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Pas realizimit të aktivitetit, nxënësi, i ndihmuar mundet dë prodhojë disa fakte nga fusha të ndryshme si dhe fakte për klasën e tij duke bërë gabime të shumta që e pengojnë të kuptuarit.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Arsimtari i ndihmonte gjatë gjetjes së fakteve në tekst edhe gjatë prodhimit por edhe gjatë të kuptuarit.Bashkënxënësit i ndihmonin gjatë gjetjes dhe hartimit të fakteve duke aplikuar informata prej internetit.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktiviteti mund të aplikojet në lëndën e biologjisë.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Bllagica Çatlevska

Shkolla: SHF "Goce Dellçev" - Prilep

Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë angleze:
Transmetimi i fakteve dhe i mendimeve
(lexim, shkrim dhe të folur) me zbatimin e TIK-ut.

Titulli i aktivitetit: Shkrimi dhe leximi i drejtë të fjalive të shkurtra

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënës në klasën e gjashtë me vështirësi të përvetësimit të përmbajtjeve mësimore. Te ky nxënës vërehen vështirësi në socijalizim, në pamundësi të orientimit në hapësirë dh vështirësi në mbajtjen e vëmendjes.

Qëllimet e aktivitetit:

- nxënësi të mësojë shkrim lexim;
- lexim;
- të shkruarit;
- përqëndrim i vëmendjes;
- motivim.

Përshkrim i aktivitetit. Lexim i një teksti të shkurtër, përshkrim sipas normave gramatikore dhe bisedë për përmbajtjen e tekstit. Gjatë orës punohej në mënyrë individuale me nxënësin me shpjegim, me të shkruar dhe njohje. E gjithë kjo punohej me fletëza mësimore të përgatitura më parë dhe gjatë punës kishte nevojë për ndihmë (prej ndonjë nxënësi). Bashkëpunimi me nxënësin gjatë aktivitetit nuk ishte në nivelin e duhur, por më vonë me dhënien e detyrave më interesante, bashkëpunimi ishte në nivel më të lartë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë mësimit u përdorën edhe pajisje ndihmëse (tastiera me taste të mëdha), ndërsa prej softuerit edukativ GCompris.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nëpërmjet detyrave të dhëna, nxënësi fitoi njohuri dhe aftësi për shkrim-lexim, përkatësisht e arritëm qëllimin tonë dhe nxënësi është i aftë për përcjelljen e mësimit dhe për kalim në qëllime më të rënda.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë procesit të mësimit është kyçur edhe nxënësi që ult afër tij me detyrë të ndihmojë shokut në përvetësimin e detyrës së dhënë.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të aplikohet në korelacion edhe me arsimin figurativ edhe me gjuhën angleze në formë të shkruar dhe në vizatim.

Emri i arsimtarit: Branka Stamenkova
Shkolla: SHF "Sllavço Stojmenski" - Vinicë
Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë maqedonase: Shkrim-leximi

Titulli i aktivitetit: Përvetësimi i vokabularit për pjesët (gjymtyrët) e trupit

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënës i klasës së shtatë, me vështirësi të prëvetësimit të përmbajteve mësimore. Te ky nxënës më tepër në shprehje vie disgrafia e dorëshkrimit (është shumë i pakuptueshën) dhe nuk ka të foluit e zhvilluar.

Qëllimi i aktivitetit:

- nxitje e të folurit;
- ti mësojë pjesët e trupit në gjuhën angleze;
- motivimi;
- përqëndrimi i vëmendjes.

Përshkrimi aktivitetit. Ky aktivitet kryhet në mënyrë individuale edhe me çifte. Përsëritje të fjalëve psi i thotë arsimtari dhe shkrim i tekstit. Gjatë mësimit përdoret shpjegimi, diskutim, bisedë, dëgjim i këngës dhe pastaj ta këndojnë bashkërisht. Bashkëpunimi me këtë nxënës ishte i mirë, në mënyrë të lehtë u krijua kontakt, ishte i inetersuar për mësimin.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Prej pajisjeve ndihmëse u përdor tastiera me taste të mëdha dhe kartelat flesh si dhe ueb faqja e internetit

www.englishexercises.org/makeagame/viewgame.asp?id=6543

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitimet nga kjo orë janë të mëdha sepse u arritën qëllimet e përcaktuara për këtë orë mësimore, vetë e kryente detyrën e dhënë, i mësoi pjesët e trupit ti thotë edhe në gjuhën angleze dhe këngën e cila u prezantua para të gjithë nxënësve, e mësoi përmendsh.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë orës së mësimit, në momente të caktuara përfshihej nxënësi që ulej afër tij për t'i ndihmuar, përkatësisht nxënësi kishte nevojë për ndihmë gjatë punës me internet.

Roli i defektologut është që sa më tepër ta mbajë vëmendjen e nxënësit dhe ta mbështes atë.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të zbatohet edhe në gjuhën maqedonase, arsim muzikor dhe figurativ, në formë të përsëritjes, të vizatimit dhe të kënduarit.

Emri i arsimtarit: Marina Spasova

Shkolla: SHF "Sllavço Stojmenski" - Vinicë

Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë angleze: Pjesët (gjymtyrët) e trupit

Titulli i aktivitetit: Instrumentet popullore me tela – tamburaja dhe violina

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi është talent për muzikë dhe shumë e do atë, ka probleme me dëgjimin për çka has në vështirësi më të mëdha gjatë përcjelljes së mësimit. Por me përdorimin e TIK-ut dhe të teknologjive ndihmëse gjatë orës së mësimit mundësohet arritja e suksesshme e qëllimeve. Nxënësi me ndihmë të vogël prej arsimtarit, lehtë i përvetëson qëllimet e parapara dhe me kënaqësi i ndjek orët nga arsimi muzikor.

Qëllimi i aktivitetit:

- Ta përvetësojë ndarjen e instrumenteve muzikore popullore;
- Ti njohë dhe ti emërtojë vizualisht instrumentet popullore;
- Ti klasifikojë instrumentet sipas mënyrës së të luajturit;
- Të zhvillojë aftësi për dëgjim të ndonjë vepre muzikore (ose fragment i rrumbullaksuar);
- Të inkurajohet për ti shfaqur përshtypjet (gojarisht ose nëpërmjet ndonjë vepre artistike) personale nga muzika e dëgjuar;
- Të inkurajohet për njohje me të dëgjuar të zërimit me dur dhe mol në kompozime.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Aktiviteti hyrës: Numërimi i instrumenteve që i takojnë grupit të instrumenteve muzikore popullore me tela dhe përsëritje e shkurtër e instrumenteve kavallit dhe fyellit.

Pjesa kryesore (aktivitete për mësim dhe nxënie): tamburaja: pjesë prej të cilëve është ndërtuar instrumenti; mënyra e rënies së instrumentit tambura; ngjyra e zërit të instrumentit të tamburasë; dëgjim i një fragmenti të tamburasë; violina: pjesë prej të cilave është ndërtuar instrumenti; mënyra e luajtjes me anë të violinës; ngjyra e zërit të violinës; dëgjim i një fragmenti me anë të violinës.

Pjesa përfundimtare (aktivitete për evaluim): Të ndarë në çifte, nxënësit përgjigjen në detyrat e dhëna prej përmbajtjeve digjitale* (vetëm për instrumente popullore me tela); krijim i fletës mësimore (sipas grupeve). Format e punës: frontale, individuale dhe në grupe; Metodat mësimore: e demonstrimit dhe bashkëbiseduese. Mjete mësimore: libri, fotografi dhe shembuj instrumentesh, kompjuter, LCD projektor, kufje (të dedikuara për nxënës me dëmtim të të dëgjuarit), përmbajtje digjitale, CD, fletëza mësimore.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë orës së mësimit janë përdorur këto linqe:

http://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A8%D1%83%D0%BF%D0%B5%D0%BB%D0%BA%D0%B0

http://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9A%D0%B0%D0%B2%D0%B0%D0%BB

http://www.youtube.com/watch?v=gcvtoBIPAos

http://www.youtube.com/watch?v=6QkfDX4AwOo

http://www.youtube.com/watch?v=x2CZ3_f1Vy8



Gjatë orës së mësimit, nxënësi ka përdorur këto programe kompjuterike: Paint (nxënësit i shprehin përshtypjet e tyre nga të dëgjuarit e muzikës me punime të artit), MagicScore Note 7 (shkruarja e notave) dhe Microsoft Word (për përpunimin e tekstit).

Gjatë orës së mësimit, nxënësi, nga teknologjia ndihmëse, ka përdorur kufjet, sepse një prej nxënësve është me dëmtime më të rënda të të dëgjuarit.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Pas realizimit të aktivitetit, përfitimet janë të dukshme si dhe niveli i arritjes së qëllimeve të caktuara më parë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Qëndrimi pozitiv nga ana e nxënësve tjerë kontribuon në realizimin e suksesshëm të aktivitetit.

Zbatueshmëria e aktiviteit. Ky shembull praktik mund të inspirojë edhe arsimtarë tjerë që në mënyrë të suksesshme ta përdorin teknologjinë ndihmëse në mësim në cilëndo lëndë mësimore nëpër shkolla.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit: Llarisa Zhulina-Mitovski, profesoreshë e arsimit muzikor

Shkolla: SHF "Joakim Krçovski" – Kriva Pallankë

Lënda mësimore: arsim muzikor, kl. VI:
Instrumentet popullore me tela – tamburaja dhe violina (përmbajtje digjitale)

*** Shënim:** përmbajtjet digjitale dhe fletëza mësimore që janë përdrur gjatë aktivitetit, janë të përgatitur nga Byroja për zhvillim të arsimit në Republikën e Maqedonisë.

Titulli i aktivitetit: Punë projektuese: Revista e klasës sime

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi ka vështirësi të lehta në zhvillimin psiqik dhe dëmtim të vogël të të paurit. Mund të ndjekë të gjitha orët nga lënda e gjuhës frenge. I duhet më tepër kohë për formulimin e përgjigjeve dhe të përshkrimit të shpjegimeve si dhe të detyrave të dhëna. Ka nevojë për ndihmë nga arsimtari ose nga bashkënxënësi gjatë përvetëimit të elementeve gjuhësore, leksike dhe të atyre gramatikore.

Te nxënësi vërehet vëmendje me kohëzgjatje të shkurtër lidhur me aktivitetin e dhënë, të menduarit dhe të mbajturit mend nuk janë në nivelin e duhur, vetëm një pjesë prej aktiviteteve të prezentuara arrin ta reprodukojë dhe ta prezantojë. Ka percepcion të mirë auditiv, por gjjatë perceptimit vizuel ka vështirësi, regjistron zëra, vëren karakteristka të rëndësishme të fotografisë. Ka vështirësi gjatë orientimit në kohë dhe në hapësirë. Lexon me ndihmën e arsimtarit ose të bashkënxënësit, shkruan vetë por ngadalë, ka vështirësi në të shprehur dhe gjatë shqiptimit të disa zanoreve të sistemit fonetik të gjuhës frenge. Ka vështirësi gjatë realizimit të situatave komunikative.

Ai lehtë komunikon me moshatarët e tij, adaptohet në situata të reja dhe persona të rinj. Tiparet më karakteristike të nxënësit për punë në orën e mësimit të gjuhës frenge anë interesimi i madh dhe kërshëria për kryerjen e detyrës së dhënë në punëtori përkatëse (p.sh. shkruarje e të dhënave peronale në mënyrë më të shkurtër, përshkrim i një ylli të preferuar, shkruarja e urimit për Vitin e Ri etj.).

Qëllimi i aktivitetit. Nxënësit sipas Webkuestit të shpërndarë më parë, duhet të krijojnë revistë në të cilën do ti paraqesin të gjithë nxënësit e klasës së tyre. Çdo nxënës duhet të prezantohet me fotografi personale dhe disa fotografi të cilat do ti përshkruajnë shijet e tyre lidhur me shkollën dhe yllin e tij të preferuar.



Përshkrim i aktivitetit. Sipas numrit të ditarit, nxënësit ndahen në tre grupe me nga katër nxënës. Secili anëtar i grupit ka detyrën e vet:

- Grupi i parë do ta punojë faqen e parë (mbulesën) të revistës (zgjedh emrin e revistës, mbledh fotografi të dhura, vizatime, simbole të shkollës dhe të klasës, i ngjet fotografitë dhe e prezanton faqen e parë).

- Grupi i dytë e përgatit pjesën e brendshme dyfaqëshe të revistës. Pasiqë çdo nxënës do të sjell tekst të shkurtër në të cilin e pparaqet vetveten dhe shije e tyre lidhur me shkollën dhe yllin e ij të preferuar, i ngjet fotografitë e nxënësve dhe pranë çdo fotografie ka paraqitje të shkurtër për çdo nxënës.
- Grupi i tretë mbledh informata për numrat e telefonave dhe E-mail adresat për seilin nxënës dhe i shënon informatat e duhura në faqen e fundit të revistës.

Materijale të duhura. Për kryerjen e kësaj detyre, duhet këto materijale:

- 2 fleta të formatit A4;
- fotografi e vogël për secilin nxënës;
- disa fotografi që i shprehin shijet e secilit nxënës me shkollën e tyre (lëndë mësimore të preferuara) dhe yllin e preferuar për secilin nxënës;
- fotografitë mund të gjinden në : www.francaisfacile.com(FLE:Rentree scolaire).

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Përdorim i tastierës së adaptuar me taste të mëdha.
Linku i përdorur: www.francaisfacile.com(FLE:Rentree scolaire)

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përpunimi i detyrës projektuese do ta motivojë nxënësin ta shprehë kreativitetin e tij dhe në të njëjtën kohë më lehtë ti mbajë mend dhe t'i praktikojë strukturat leksikore dhe gramatikore (emri, mbiemri, adresa, profesioni, ylli i preferuar) nëpërmjet lojës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

- përvetësim i njohurive për punë e kompjuter dhe punë të pavarur me kompjuter,
- përvetësim i njohurive për përdorimin e internetit dhe punë me programet Word dhe Power point,
- përmirësim i shkathtësivepër shkrim dhe lexim,
- ruajtja dhe drejtimi i vëmendjes,
- nxitje e kreativitetit,

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë detyrës, nxënësi me nevoja të veçanta arsimore punon me ndihmën e: arsimtarit, të bashkënxënësit, prindin dhe ekipin gjithëpërfshirës.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky shembull konkret mund të aplikohet edhe në lëndë/ përmbajtje tjera mësimore, veçanëtisht gjatë përpunimit të detyrave projektuese, sepse në atë mënyrë njësitë mësimore nxënësit më mirë do ti kuptojnë nëpërmjet lojës dhe me këtë do të mbështetet procei edukativo-arsimor.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit: Irena Naumovska
Shkolla: SHF "Goce Dellçev" - Prilep
Lënda mësimore: gjuhë frenge

Titulli i aktivitetit: Kompjuteri si mjet mësimor për përvetësimin e njohurive në fushën e gjeometrisë te nxënësi me paralizë cerebrale

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja është e vyeshme, e qëndrueshme, e zellshme dhe gjithnjë e gatshme për përvetësimin e njohurive dhe detyrave të reja. Tregon disa vështirësi në përvetësimin e materijalit nga lënda e matematikës, veçanërisht në fushën e operacioneve matematikor, për çka detyrat dhe përmbajtjet mësimore janë të përshtatura në pajtueshmëri me mundësitë dhe aftësitë e saj. Përshkak të gjendjes së saj – paralizë cerebrale, ka vështirësi gjatë aktiviteteve manipulative, siç janë të shkruajturit, vizatimi, prerja, ngjitja dhe servisimi. Në procesin mësimor, për realizimin e detyrave në gjithë lëndët mësimore, nxënësja përdor teknologji ndihmëse. Kompjuteri për të është fletore, letër e bardhë, fletë për vizatim, fletore për hartim me shkrim...Me ndihmën e arsimtarëve lëndor, të defektologut dhe të shokëve e shoqeve, për çdo ditë me sukses i kryen detyrat e dhëna. Pikërisht kompjuteri është mjeti i vetëm nëpërmjet të cilit nxënësja mund të fiojë dhe të praktikojë njohui nga fusha e gjeometrisë.

Qëllimi i aktivitetit. Qëllimi i aktivitetit është që nxënësja **t'i njohë dhe ti emërtojë llojet e këndeve sipas madhësisë.** Qëllimi mësimor është pjesë e planit individual arsimor dhe është i përshtatur sipas vëllimit dhe përmbajtjes si dhe i modifikuar sipas aplikimit të mjeteve mësimore dhe mënyrës së zbatimit. Detyrat nga fusha e gjeometrisë, ndikojnë pozitivisht, posaçërisht në drejtim të motivimit të nxënëses, sepse shumë më lehtë dhe më shpejt i zgjidh detyrat.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Aktiviteti fillon duke shfaqur lloje të ndryshme këndesh nga arsimtari i lëndës, ndërsa nxënësit i emërtojnë ato. Nxënësive tjerë u jepet detyrë që t'i zgjedhin detyrat prej librit, ndërsa nxënësja mer udhëzime për gjetjen e linkut: **http://skoool.mk/**. Në ueb faqen e internetit, nxënësja sëpari e dëgjon prezantimin për llojet e këndeve dhe të njëjtën kohë i përsërit ato. Pas kësaj u përgjigjet pyetjeve (shembull, П1: si është këndi i ngjyrosur me ngjyrë të verdhë? - janë ofruar më shumë përgjigje). Pastaj, në linkun e njëjtë pason detyra ku nëpërmjet simulimit për këndmatësin i vërteton vlerat e mundshme të këndeve (i mprehtë, i drejtë, i topitur). Si aktivitet i fundit, nxënëses i jepet fletëz mësimore (e punuar në Word) në të cilën duhet ti ngjyrosë këndet sipas legjendës së dhënë (e kuqe – kënd i mprehtë, e verdhë – kënd i drejtë, blu – kënd i topitur). Gjatë aktivitetit, nxënësja është e inkurajuar dhe përcillet nga arsimtari i lëndës dhe defektologu i shkollës. Nxënësja bashkëpunonte shkëlqyeshëm dhe

manifestonte interesimin e saj ndaj detyrave. Qëllimi i orës është arritur plotësisht.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj.) Gjatë tërë aktivitetit është përdorur kompjuteri me opcione të kapshme si dhe me pajisje ndihmëse, tastiera me taste të mëdha dhe rakbolli. Për realizimin e aktivitetit është përdorur edhe ueb faqja e internetit: **http://skoool.mk/**, si dhe programi Word.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësja, me aplikimin e kompjuterit në mënyrë të barabartë ishte e përfshirë në orën e mësimit, e angazhuar dhe me sukses i kreu detyrat. Bëri përsëritje për llojet e këndeve dhe i përforcoi njohuritë e fituara. Gjithashtu, përfitimet janë të padiskutueshme përpërforcimin e kapaciteteve socio-emocionale, si ngritje e vetbesimit në nivel më të lart, interesimi dhe motivimi për mësimin dhe ndjenjat e kënaqësisë prej suksesit të arritur.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë realizimit dhe aktivitetit, si ndihmë dhe mbështetje u përfshinë arsimtari i lëndës dhe defektologu duke dhënë udhëzime dhe duke parashtruar pyetje. Pjesëmarrja e bashkënxënësve në këtë aktivitet mungon por më shpesh manifestohet në mbështetje gjatë kyçjes dhe çkyçjes së kompjuterit,të diktimit, hapje e librit për kohëzgjatjen e orës mësimore. Përfshirja e prindërve reflektohet në marrjen e udhëzimeve si ti kryejnë detyrat e shtëpisë nga fusha e gjeometrisë.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktivitetet dhe përmbajtjet mësimore që kërkojnë gjindëshmëri manipulative siç është të vizatuarit dhe ngjyrosja në lëndën e arsimit figurativ apo vizatim grafik nga arsimi teknik, mund të modifikohen dhe realizohen me ndihmën e kompjuterit dhe resurse të dobishme nëpërmjet internetit, të regjistruar në planin individual arsimr ë cilët do të mundësojnë pjesëmarrje të barabartë të nxënësve me paralizë cerebrale në procesin mësimor.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Ivana Dvojakova – defektologe e diplomuar

SHkolla: SHF "Johan Hajnrih Pestaloci" - Shkup

Lënda mësimore/ njësia mësimore: matematikë:
Përsëritje për llojet e këndeve

Titulli i aktivitetit: Migrimi (shpërngulja) i madh i popujve

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi vet e përdor kompjuterin dhe shërbehet me teknologjinë ndihmëse. Gjatë procesit mësimor, me kujdes e përcjell mësimin dhe me njohjen e parë të përmbajtjeve mësimore mundet ti numërojë faktet që burojnë nga vetë përmbajtja mësimore, a pjesërisht dhe me ndihmë të arsimtarit mundet ti sqarojë shkaqet dhe pasojat për paraqitjen e ndonjë ndodhie (në këtë rast migrimi i madh i popujve në mesjetë).

Qëllimi i aktivitetit:

- Nxënësi ti kuptojë shkaqet dhe pasojat që kanë lindur me migrimin e madh të popujve;
- Të mundet ti numërojë popujt që e filluan dhe e vazhduan migrimin e madh të popujve;
- Të kuptojë për mënyrën e jetesës të një prej popujve që morën pjesë në migrimin e madh të popujve (Hunët);
- Të motivohet për punë hulumtuese duke përdorurinternetin.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Arsimtari ua sqaron shkaqet për të cilat disa prej popujve e filluan migrimin e tyre. Gjatë ligjërimit, para nxënësve prezantohen fotografi prj atyre popujve me karakteristikat e tyre (mënyra e veshjes, pamja e një luftëtari, profesioni etj.) Nëpërmjet fotografive, nxënësit japin mendimet e tyre për ndonjë popull të caktuar, shënohen në hartën gjeografike, përkatësisht ngjiten fotografi, nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr nga një popull që pastaj të hulumtojë në internet për atë popull (udhëzime të duhura lidhur me faqen e internetit u jep arsimtari).

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj. Nxënësit i jepet detyrë që të kërkojë dhe hulumtojë në internet një popull i cili ka marrë pjesë në **Migrimin e madh të popujve** (në këtë rast nxënësi mori detyrë të hulumtojë për Hunët).

- Pas hulumtimit e nevojshme është që nxënësi ti klasifikojë në një dokument të veçantë karakteristikat për të cilat ai mendon se janë të rëndësishmet për Hunët.
- linqet:

  file:///H:/Hun_Empire.gif
  http://kalendar-jovanovski.blogspot.com/2011/10/441-453.html
  http://steppes.proboards.com/thread/718/pictures-huns?page=1#scrollTo=13991

- Nxënlsi përdor tastierë me taste të mëdha, trakboll dhe përshtatje softuerike të hapësirës së punës, përshtatje të lëvizjes së mausit dhe përshtatjet e duhura të tastierës.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësi i arriti qëllimet e përcaktuara duke përdorur teknologjinë ndihmëse për të punuar një projekt për Hunët të cilin e prezantoi me sukses.



Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë mësimit, nxënësja kishte ndihmë prej disa nxënësve të klasës. Pas mbarimit të njësisë mësimore kishte bashkëpunim ndërmjet arsimtarit dhe prindit, për çka prindit i përcollën informata lidhur me detyrën e dhënë për në shtëpi që duhet të realizohet (me ndihmën e prinit, detyra u krye plotësisht).

Zbatueshmëria e aktivitetit. Aktiviteti mund të zbatohet në lëndë të nryshme edhe në njësi tjera mësimore. Në këtë mënyrë, nxënësi merr pjesë aktive gjatë orës mësimore.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit/ anëtar i shërbimit profesional:
Vllatko Troshanski

Shkolla: SHF "Johan Hajnrih Pestalloci" - Shkup

Lënda mësimore/ njësia mësimore: histori:
Migrimi (shpërngulja) i madh i popujve

Titulli i aktivitetit: Si të arrihet te motivimi më i madh, vetbesimi dhe njohuri

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësja në shkollë vjen me karrocë invalidore që e përdor edhe si karrige gjatë mësimit. Perceptimi auditiv është më i zhvilluar se ai vizual. Shkak për këtë janë lëvizjet spastike të të gjithë muskulaturës dhe të kokës me të cilën edhe ka vështirësi për ta mbajtur një kohë më të gjatë në pozitën e njëjtë. Me vëmendje të kahëzuar i përcjell aktivitetet e orës së mësimit. Të mbajturit mend është e zhvilluar mirë, mban mend fakte të rëndësishme prej orëve të mësimit. Nxënësja shkruan me ndihmën e kompjuterit të cilin e kyç vet, di të hap dokument të ri dhe ta ruaj atë. Lexon në mënyrë të pavarur, por i duhet më tepër kohë. Ka vështirësi gjatë të folurit dhe theksimi i disa bashkëtingëlloreve që i përzien, më shpesh ato të zëshmet me të pazëshmet për shkak të spazmës, a kjo ka reperkusion edhe gjatë të shkruajturit (shkruan se si shqiptohet). Është mirë e pranuar prej nxënësve tjerë dhe ka ndihmë gjatë përpunimit të ushtrimeve dhe punës me kompjuter. Për arsye se ka vështirësi gjatë të shprehurit kishte dhe komunikim të kufizuar me moshatarët, por tani mirë e përdor kompjuterin dhe komunikon me nxënësit tjerë nëpërmjet rrjeteve sociale. Me kompjuter ndjehet më e sigurt aq sa edhe detyrat e shtëpisë i shkruan vet dhe i dërgon nëpërmjet postës elektronike.

Наставен лист (прилог 1)
(вежба за аншеч)
1. Подели ги зборовите на слогови
компјутер
цвеќе
срце
уво
велосипед
2. Бојадиј го слогот кадешто треба да стои акцентот во горе наведените зборови

Qëllimi i aktivitetit:

- të dijë në mënyrë të drejtë të bëjë ndarjen e fjalëve në rrokje;
- të dijë në mënyrë të drejtë ta përdor theksin në fjalët një, dy dhe trirrokëshe;
- shkruarja dhe shqiptimi i drejtë i disa bashkëtingëlloreve që i përzien si më shpesh.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Derisa me nxënësit nëpërmjet lojës me pyetje dhe përgjigje përsërisim për theksin e gjuhës tonë, nxënësi me nevoja të veçanta arsimore me ndihmën e një bashknxënësi e hap lojën edukative "Loja e shkronjave" dhe mer për detyrë të formulojë disa fjalë me gjatësi të ndryshme të rrokjeve. Në kompjuter, hap Writer-in dhe e punon fletëzën mësimore që e ka përgatitur arsimtari më herët (fjalët e shkruara i ndanë në rrokje, pastaj rrokjen ku duhet të qëndrojë theksi e boldon, fjalët janë të shoqëruara me fotografi adekuate). Punon ve, nëse i duhet ndihmë e ngre dorën. Gjatë kësaj kohe edhe nxënësit tjerë i punojnë ushtrimet e dhëna nga arsimtari.

Në aktivitetin përfundimtar, një nxënës i lexon ushtrimet e saj, fjalët tjera i shkruajnë në tabelë dhe i theksojnë, nxënësja i përcjell përgjigjet dhe nëse ka gabime i korrigjon. Pasi të mbarojnë me kontrollimin, nxënësja e ruan dokumentin e saj në dosjen për gjuhën maqedonase. Gjatë aktivitetit përdoret fletëz mësimore e adaptuar për qëllimet dhe aftësitë e saj. Prej formave të punës përdoret ajo frontale dhe individuale, ndërsa prej metodave: lojën, metodën ilustrative dhe tekst metoda. Nxënësja me kënaqësi i pranon detyrat e dhëna, pranon ndihmë prej shokëve tjerë, me ndihmën e kompjuterit detyrat i kryen me sukses sepse nuk është e kufizuar me kohën, para nxënësve tjerë i tregon njohuritë e saj a me këtë edhe i rritet vetbesimi dhe siguria për punë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj). Kompjuteri përdoret gjatë gjithë orës mësimore. Prej programeve komjuterike prdoret Writer për shkruarjen e tekstit dhe loja edukative "Loja e shkronjave". Prej teknologjisë ndihmëse, nxënësja përdor tastierën me taste të mëdha dhe trakboll, ndërsa prej softuerit përdoret "taste filtruese" dhe foni i zmadhuar i shkronjave.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nxënësja i kryen detyrat me shpejtësi që i përgjigjet. E zmadhon vetbesimin dhe motivimin për punë. Me ndihmën e lojës edukative, motivohet dhe mëson. Detyrat e dhëna i punon në mënyrë të pavarur ndërsa kontrollimin e bën me bashkënxënësit e klasës me çka e përmirëson komunikimin. Tregon se çka din dhe di ti ndajë fjalët në rrokje dhe ti theksojë drejt. Arrin nivel të lart të realizimit dhe të qëllimeve të caktuara. Me rëndësi është se ajo është e kënaqur.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë aktivitetit përfshihen edhe bashkënxënësit e saj, një bashkënxënës i ndihmon në hapjen e lojës edukative ndërsa në kontroll marin pjesë të gjithë, një i lexon ushtrimet që i ka punuar, një tjetër i shkruan fjalët në tabelë dhe pastaj i theksojnë. Prej këtu bëhet edhe kontrolli ndërsa arsimtari gjithnjë i përcjell aktivitetet dhe e koordinon orën e mësimit.

Emri i arsimtarit: Biljana Jagurinoska
Shkolla: SHF "Goce Dellçev" - Prilep
Lënda mësimore/ njësia mësimore:
gjuhë maqedonase: Ushtrime për theksin

Titulli i aktivitetit: Kultura në botë dhe në Europë prej shek. XVIII deri në Luftën e Parë Botërore (ta hulumtojë arqitekturën – ndërtimet karakteristike në Europë prej shek. XVIII)

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi punon në mënyrë të pavarur, por me ndihmë të vogël prej arsimtarit ose të një nxënësi. Është i interesuar dhe plotësisht i arrin qëllimet nga historia të parapara sipas Planit individual arsimor. Atë që e do e punon me pasion të madh në detyrën e dhënë.

Qëllimet e aktivitetit:

- të dijë të njohë prej cilës periudhë janë bërë ndërtimet;
- ti ballafaqojë ndryshimet e ndërtimmeve;
- të mësojë për ariktekturën e asaj periudhe;
- të dijë të kërkojë në internet;
- të dijë ti përdor veglat e Word-it;
- të dijë të kopjojë fotografi dhe të prezantojë;
- të mësohet ta aplikojë përmbajtjen.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Nxënësit ia dha detyrë ta hulumtojë arkitekturën e qyteteve europiane prej shekullit XVIII. Sipas zgjedhjes së tij, u përcaktua për disa qytete, edhe atë për Londrën dhe Parisin. Nxënësi përdorte kompjuterin për të mbledhur dhe ngjitur fotografi të duhura të cilave u bashkangjiste edhe nga pak tekst për të sqaruar disa prej ndërtimeve të vjetra. Punonte individualisht me ndihmë të vogël të arsimtarit apo të një nxënësi. Gjatë përcjelljes së punës, arsimtari jepte udhëime se si të bëhet mbledhja e materialeve për të përgatitur prezantim të mirë. Në fund, aktiviteti mbaroi me prezantim para të gjithë nxënësve në klasë, ndërsa në sytë e nxënësit vërehej kënaqësia nga puna e bërë. Me këtë aktivitet, nxënësit i jepet mundësi që në mënyrë vizuele të mbajë mend disa prej ndërtimeve, ta kuptojë qëllimin e tyre si dhe të ketë ndejnja për estetikën dhe të bukurën. Kjo mund të ketë aplikim gjatë vizitës së disa qyteteve. Ishte i motivuar, sepse arsimtari gjithnjë e inkurajonte se mund të arrij sukses dhe kjo ndikoi që ta kryejë punën pa vështirësi më të mëdha.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj). Gjatë punimit dhe realizimit të përmbajtjes punohej me kompjuter duke përdorur tastierën me taste të mëdha dhe trakbollin si dhe përdorimin e internetit për kërkim të materialeve të duhura që i ka dhënë arsimtari për ta lehtësuar punën, por edhe nxënësi, i motivuar kërkonte edhe nëpër tjera faqe të internetit.

https://www.google.com/search?q=london&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ei=EXg3UqGAIYnsswaq9IHIAg&ved=0CAkQ_AUoAQ&biw=1017&bih=403&dpr=1

http://en.wikipedia.org/wiki/London

https://www.google.com/rch?q=%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%B8%D0%B7&client=ubuntu&hs=0l7&channel=fs&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ei=R2k7Uuf_Ic7CtAbAyIHQDQ&ved=0CAkQ_AUoAQ&biw=1017&bih=403&dpr=1

http://www.ajdenaodmor.mk/vest/33608/Shto-morate-da-posetite-vo-Pariz---gradot-na-svetlinata-ljubovta-i-vinoto

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Gjatë realizimit të përmbajtjes qëllimi u arrit dhe te nxënësi manifestohej kënaqësia për punën e kryer, se mësoi edhe diçka shtesë lidhur me ndërtimet e vjetra.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Për arsye se e gjithë kjo punohej gjatë orës së mësimit, nxënësi kishte ndihmë prej arsimtarit i cili e përcillte dhe i jepte udhëzime si të bëjë mbledhjen e fotografive, si të shkruaj tekst – disa direkt i kopjonte, ndërsa nxënësi që ulej afër tij i ndihmonte kohë pas kohe aty ku ishte e nevojshme.

Emri i arsimtarit: Nevena Petkovska – profesoreshë e historisë

Shkolla: SHF "Dimo Haxhi Dimov" - Shkup

Lënda mësimore/ njësia mësimore: histori: Kultura në botë dhe në Europë prej shek. XVIII deri në Luftën e Parë Botërore

Titulli i aktivitetit: Punë projektuese: Revista e klasës sime

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënësi ka pengesa të lehta në zhvillimin mental dhe dëmtim të vogël të të pamurit. I duhet më tepër kohë për formulimin e përgjigjeve dhe për përshkrimin e sqarimeve dhe detyrave të dhëna. I duhet ndihmë prej arsimtarit ose të ndonjë nxënësi për të kuptuar ngjarje dhe personalitete të rëndësishme historike. Te nxënësi është vërejtur mbamendja e shkurtër për aktivitetin e dhënë, të menduarit dhe të mbajturit mend nuk janë në nivel të duhur, vetëm një pjesë të vogël prej aktviteteve të prezantuara është në gjendje ta reprodukojë dhe ti prezantojë. Ka preceptim të mirë auditiv por ka probleme me atë vizual, regjistron zëre, vëren karakteristika të rëndësishme në fotografi. Ka vështirësi për orientim në kohë dhe hapësirë. Lexon me ndihmën e arsimtarit apo të ndonjë nxënësi por ngadalë, ka vështirësi kur shprehet dhe në përshkrimin e ngjarjeve historike. Komunikon lehtë me nxënësit tjerë, adaptohet në situata të reja dhe persona të rinj. Tiparet më të rëndësishme për nxënësin gjatë orës së historisë janë interesi dhe kurreshtja për kryerjen e detyrave të dhëna në ndonjë punëtori të caktuar lidhur me përgatitjen e planit për aktivitetet e mëtutjeshme si p.sh. mbledhja e materijalit për prezantim, si fotografi, tekste dhe materiale tjera.

Qëllimi i aktivitetit. Nxënësit duhet të përgatisin poster për njësinë mësimore "Zbulimet e mëdha gjeografike" në të cilin marrin pjesë të gjithë nxënësit e paraleles. Çdo nxënës ka obligimet dhe detyrat e veta.

Përshkrim i aktivitetit. Nxënësit ndahen në katër grupe me nga pesë nxënës sipas numrit të ditarit. Secili anëtar i grupit do të punojë sipas detyrave të caktuara për secilin veç e veç.

- Grupi i parë, hulumton për shkaqet e zbulimeve gjeografike (mbledh fotografi, vizatime, tekste, i ngjesin fotografitë në vendet përkatëse dhe prezanton)
- Grupi i dytë, mbledh informata të duhura për zbulimin e Amerikës dhe rrugën për në Indi (secili nxënës do të sjell tekst të shkurtër, fotografi, vizaton skemë , vizaton hartë...)
- Grupi i tretë mbledh informata për udhëtimin e parë rreth botës (tekst i shkurtër, fotografi dhe hartë)
- Grupi i katërt hulumton për rëndësinë e zbulimeve gjeografike (sjellin shembuj prej kulturave bujqësore që europianët i anë dërguar në Amerikë a që kanë qenë të sjellura nga kontinentet e sapozbuluar në Europë dhe i ngjesin aty)

Materijale të evojshme. Për kryerjen e kësaj detyre, janë të nevojshëm këto materijale:

- 4 letra të formatit A4;
- flomasterë, kultura bujqësore;
- fotografi, skema të hartave gjeometrike, tekste.

Fotografitë mund ti gjeni me zbatimin e TIK-ut: http://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%93%D0%BE%D0%BB%D0%B5%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5_%D0%B3%D0%B5%D0%BE%D0%B3%D1%80%D0%B0%D1%84%D1%81%D0%BA%D0%B8_%D0%BE%D1%82%D0%BA%D1%80%D0%B8-%D1%82%D0%B8%D1%98%D0%B0

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj). Tastiera e adaptuar me taste të mëdha. Linku i përdorur: http://mk.wikipedia.org/wiki/

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Punimi i kësaj detyre projektuese, do ta motivojë nxënësin për ta shprehur kreativitetin e tij, a në të njëjtën kohë më lehtë ti mbajë mend zbulimet e reja gjeografike të zbuluar nëpërmjet lojës dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Qëllimet e arritura janë:

- përvetësim i njohurive për punë me kompjuter dhe përdorimi i tij;
- përvetësim i njohurive për përdorimin e internetit dhe punë me programet Word dhe Power Point;
- përmirësim i shkathtësive për shkrim dhe lexim;
- përqëndrim dhe drejtim i vëmendjes;
- inkurajim i kreativitetit.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Gjatë detyrës, nxënësi me nevoja të veçanta arsimore, punon me ndihmën e arsimtarit, të bashkënxënësit, prindit dhe të ekipit (inkluziv) gjithëpërfshirës.

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky shembull praktik mund të zbatohet edhe në lëndë tjera mësimore, sepse në këtë mënyrë nxënësit do të munden më lehtë ti kuptojnë njësitë mësimore dhe do të mbëdhtetet procesi edukativo-arsimor.

Emri dhe mbiemri i arsimtarit: Velika Lesnoska
Shkolla: SHF "Goce Dellçev" - Prilep
Lënda mësimore: histori

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Në projektin e shkollës "Prej nesh për ne", i krijuar nga shërbimi profesional, u përfshinë 15 mnxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe me probleme zhvillimore si dhe nxënës të talentuar prej kl. I – VIII.
Në mesin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe me probleme zhvillimore, kishte edhe nxënës me autizëm, me sindromin e Daunit, sindromin e Vilijamsit, me probleme të kombinuara, me aftësi të kufizuara intelektuale, vështirësi në të mësuarit, probleme me motorikën, probleme me të folurit.

Qëllimi i aktivitetit:

- zhvillimi i motrikës te nxënësit me probleme zhvillimore dhe me nevoja të veçanta arsimore;
- përdorim i kompjuterit dhe ueb portale arsimore (Tnihkquest);
- kultivimin e aftësive kreative dhe zhvillimin e formësimit estetik të sendeve me materijale natyrore;
- bashkëpunimi dhe puna ekipore me bashkënxënësit;
- kultivimi i të mësuarit me bashkënxënësit;
- zhvillimi i kompetencave të biznesit te nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe te nxënësit tjerë që marrin pjesë në projekt.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit.

Aktiviteti i parë - Duke përdorur formën e punës Stuhi idesh, nxënësit u shprehën se çka duan të punojnë, përkatësisht të vizatojnë nga disa vizatime edhe në kompjuter. Pas kësaj u organizua punëtori me nxënësit në kabinetin e informatikës në të cilin nxënësit duke bashkëpunuar ndërmjet tyre dhe duke kultivuar të mësuarit e përbashkët, krijuan vepra artistike me motive sipas dëshirave të tyra. Punimet e punuara nga ana e nxënësve ua dhanë prindërve që ti vendosin në korniza.

Aktiviteti i dytë - Në punëtorinë e dytë, përveç nxënësve morën pjesë edhe prindërit e tyre dhe defektologë. Të gjithë sëbashku, i formësuan sendet estetikisht me materijale natyrore. Si produkt final u bënë kutitë dekorative.

Aktiviteti i tretë - SI aktivitet i tretë ishte ornanizimi i ekspozitës nga punimet e nxënësve (të punuar me dorë dhe me anë të kompjuterit) dhe kutitë dekorative si dhuratë. Nxënësit patën detyrë ti shesin punimet dhe të hollat e mbledhura ti dedikojnë për mjete ndihmëse mësimore në shkollë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj). Ë realizimin e një pjese të aktiviteteve u përdorën kompjuterët nga kabineti i informatikës, gjithashtu nxënësit u bashkangjitën me idetë dhe punimet e tyre

në portalin arsimor Thinkquest. Në këtë portal, u paraqitën të gjitha aktivitetet dhe përfitimet që kanë të bëjnë lidhur me temën. Nëse shkolla posedon pajisje ndihmëse, ato do të ishin ndihmesë e madhe për nxënësit dhe do të kishin kontribuuar për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parapara sipaps planifikimit.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, nxënësit kanë mundësi të aftësohen për shkathtësi jetësore nëpërmjet gjindëshmërisë në situata të ndryshme, klutivimin e komunikimit dhe të mësuarit me bashkënxënësit, planifikim dhe organizim, punë ekipore, punë me kompjuter, zhvillimin e kreativiteteit dhe të inovacioneve, kultivimin e shkathtësive sociale dhe interkulturale, fleksibilitet dhe aftësim si dhe zhvillim të karrierës.



Përfshirje të bashkënxënësve dhe prindërve. Në këto aktivitete ishin të përfshirë edhe bashkënxënës tjerë, prindër, defektologë dhe shërbimi profesional. Bashkënxënësit, prindërit, defektologët dhe shërbimi profesional ishin në rolin e drejtuesve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe probleme zhvillimore dhe u ofron mbështetje gjatë punimit të veprave të tyre.

Kha e erealizimit. *Tetor – Nëntër, 2010.*

Zbatueshmëria e aktivitetit. Ky aktivitet mund të aplikohet në suazat e orientimit profesional të nxënësve (zhvillimi i karrierës), punësim etj. Në suazat e lëndëve msimore arsim figurativ dhe informatikë.

Me këtë projekt, shërbimi profesional dhe nxënësit morën pjesë në ortalin arsimor Thinkquest për çka edhe fituan sertifikate.

Emri dhe mbiemri i anëtarit të shërbimit profesional:
Sonja Kazakova - pedagoge, Elizabeta Ivanoviq - psikologe
Shkolla: SHF „Jan Amos Komenski“ - Shkup

Të dhënat për fëmijët - Në shkollën tone kemi nxënës me dilseksi, Hiperaktivitet, probleme me të pamurit,dëmtime intelektuale.

Nxënësi tone bashkë me arsimtarët bashkpunojn në mësim. Ju jipet më shumë për ygjrdhjen e detyrave .

Qëllimi I aktivitetit - Qëllimi është që ti kycim edhe këto nxënës në mësim, te ndjehen të barabart me nxënësit tjer. Etj.

Përshkrim I aktiviteteve - Me nxënësit punuam me fotografi,vizatime, Libra. Me nxënësit kisha bashkëpunim të mirë.

Pordorimi i teknologjis informative - Programet që përdoren jan, Sistemi operativ Ubuntu, Paketa programore OpenOffice.org

Të arriturat e nxënësve dhe të qëllimit - Nxënësit patën sukses,u përmisuan në lexim,dhe ja arritëm qëllimit për përmisimin e tyre.

Bashkpunimi me bashkëpuntorët dhe prindërit - Bashkëpunimi me prindërit është shum i vogël.

Psikologu :Arife Ademi
SHF "Dituria" - Likovë

Titulli i aktivitetit: Njohja (dallimi) i fjalive të thjeshta dhe të përbëra

Përshkrim i shkurtër i aftësive dhe i vështirësive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Nxënës në klasën e tetë me vështirësi në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore. Te ky nxënës më tepër vërehet diskgrafia në doreshkrim (shkrimi nuk është shumë i kuptueshëm) dhe vërehet edhe të folurit e pazhvilluar (alalija), përqëndrim i vështirë i vemëendjes. Gjithnjë i duhet ndihmë.

Qëllimi i aktivitetit:

- të mësojë se si ti njohë (dallojë) fjalitë e thjeshta dhe të përbëra;
- nxitje e të folurit;
- motivimi;
- përqëndrimi i vëmendjes.

Përshkrim i shkurtër i aktivitetit. Realizimi i aktiviteit me këtë nxënës bëhet në mënyrë individuale dhe në çifte. Me ndihmë të personit profesional (defektologut) ajo realizohej nëpërmjet fletëzave mësimore, me shkruarjen e fjalive, me bisedë, me sqarim, njohje të tekstit dhe të fjalive. Bashkëpunimi me nxënësin nuk ishte në nivelin e duhur, me që komunikimi realizohej shumë vështirë edhe vëmendja nuk mund të përqëndrohej mirë.

Përdorimi i TI (duke përfshirë teknologjinë ndihmëse, linqe të përdorur etj. Gjatë orës së mësimit, përdorej tastiera me taste të mëdha, ndërsa prej softuerit u përdor Word për shkruarjen e fjalive.

Përfitime për nxënësin dhe arritja e qëllimeve. Përfitimet nga ora e mësimit nuk ishin të mëdha, sepse me nxënësin shumë vështirë krijua komunikim. Megjithatë, nxënësi mësoi definicionin se ç'është fjali e thejshtë, por nuk mundej ti aplikojë në detyry të caktuar por nuk kalonte në qëllimin tjetër derisa ta përvetësojë njësinë.

Përfshirje të bashkënxënësve, prindërve, arsimtarëve dhe profileve profesionale. Nxënësi që rri afër tij dhe defektologu si person profesional. Përfshirja përbëhej prej ndihmës për të shkruar dhe drejtimin e vëmendjes si dhe të koncentrimit nëpërmjet kryerjes së detyrës së dhënë.

Emri i arsimtarit: Millanka Stojanova
Shkolla: SHF "Sllavço Stojmenski" - Vinicë
Lënda mësimore/ njësia mësimore: gjuhë maqedonase: Llojet e fjalive

4

RESURSET

1. Cavanaugh W T, Assistive Technology and Inclusion, College of Education and Human Services, University of North Florida, USA
2. Cavanaugh W T, Preparing Teachers for the Inclusion Classroom: understanding assistive technology and its role in education, College of Education and Human Services, University of North Florida, USA
3. Gold E M, Lowe C, The Integration of Assistive Technology into Standard Classroom Practices: Practical Recommendation for K-12 General Education, Austion Peay State University
4. Teaching Children with Disabilities in Inclusive Settings (Embracing Diversity: Toolkit for Creating Inclusive, Learning- Friendly Environments Specialized Booklet 3), 2009, UNESCO Bangkok, URL: http://www2.unescobkk.org/elib/publications/243_244/Teaching_children.pdf
5. Hasselbring S T, Glaser H W C, Use of computer Technology to Help Students with Special Needs
6. Енциклопедија за хендикеп, 2006, URL: http://inkluzivno-obrazovanje.rs/primena-inkluzije/asistivne-tehnologije
7. Лазовски В, Гулевска М, 2012, Асистивна информатичка технологија за поголема инклузивност на образованието: анализа и препораки, Скопје, „Отворете ги прозорците“
8. Ангов А, Стојковска Алексова Р, 2010, Како да го направите компјутерот полесен за употреба: Пристапни опции во Edubuntu Linux, Скопје, Фондација Метаморфозис
9. A guide for advancing inclusive education practice, Belgrade 2009, Fund for an Open Society, Beograd URL:

   http://www.fosserbia.org/download/A_Guide_for_Advancing_Inclusive_Education_Practice.pdf

10. Chester D M, 2012, Access to Learning: Assistive Technology and Accessible Instructional Materials, Massachusetts Department of Elementary and Secondary Education

11. Assistive Technology: A Framework for Consideration and Assessment, 2008, Virginia Department of Education, URL:

http://www.doe.virginia.gov/special_ed/iep_instruct_svcs/assistive_technology/framework_assistive_technology.pdf

12. Accessible Instructional Materials: Ensuring Access for Students with Learning Disabilities, 2010, National Center for Learning Disabilities, URL:

http://www.cleweb.org/sites/cleweb.org/files/assets/NCLD_AIM.pdf

13. Booth t, Ainscow M, 2009, Приручник за инклузивни развој школе (употреба Индекса за инклузију за развој инклузивне културе, политике и праксе), Save the Children UK SEE – Програм за Србију Београд, URL:

http://www.dils.gov.rs/documents/filesEducation/mart2012/Prirucnik%20za%20Inkluzivni%20razvoj%20skole.pdf

14. Prirucnik za rad sa decom sa smetnjama u razvoju, 2008, Novosadski Humanitarni Centar (NSHC) URL:

http://www.nshc.org.rs/public/publikacije/prirucnikzaradsadecom.pdf

15. Falcon R E, Evans M, Allam C, Barett J, Forrest D, 2010, The Inclusive Learning and Teaching Handbook, Inclusive Learning and Teaching Project, University of Sheffield, URL:

http://www.sheffield.ac.uk/polopoly_fs/1.18989!/file/The-inclusive-learning-and-teaching-handbook.pdf

16. www. techdis.ac.uk

17. www.abilitynet.org.uk

PËR AUTORIN

Mr. Magdalena Dimkov-Velevska është defektologe pranë "Hapni dritaret". Është autore e disa punimeve të botuara dhe të shpallur në revista kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të prezantuar në konferenca të ndryshme.

Prej vitit 2009, si defektologe në Qendrën për teknologji ndihmëse, punon në mënyrë direkte me përdorues, me prindër, u ofron ndihmë personave profesional gjatë realizimit të procesit të (inkluzionit) gjithëpërfshirje dhe është e kyçur në mënyrë aktive në aktivitetet projektuese të shoqatës.

„Hapni dritaret" është Organizatë qytetare e përkushtuar për lehtësimin e qasjes te teknologjia informatike për personat me aftësi të kufizuara.

http://www.openthewindows.org/

Projekti i USAID-it për e-qasje të arsimit realizohet në periudhën prej vitit 2010 deri në vitin 2014. Qëllimi kryesor i projektit është që të kontribuojë në inkurajimin e gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrje aktive të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin e rregullt.

Shtypja e këtij doracaku, financiarisht është mbështetur prej popullit amerikan nëpërmjet Agjencionit të SHBA për zhvillim ndërkombëtar AUSAID, që është pjesë e misionit të SHBA-ve në Republikën e Maqedonisë. Publikimi është produkt i projektit të USAID-it për e-qasje në arsim, i realizuar nga „Hapni dritaret".

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Agjencionit të SHBA për zhvillim ndërkombëtar dhe të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.